



"ISLAMI IA RUAJTI BOTËS MBARË
E SIDOMOS ASAJ TË SOÇMES
TË MIRAT E MEJTIMIT NJERZUER"



FERMANET SULTANORE DËSHMI
TË TOLERANCËS NDËRFETARE
NË SHTETIN OSMAN



RAMAZANI, FTESË PËR
REFLEKTIM DHE RISISTEMIM
TË PRIORITETEVE

UDHA ISLAME

Viti 18 - Nr. 5 (207), Maj, 2020

www.myftinia-shkoder.org

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative



MYFTINIA SHKODER1990

Fiter Bajrami, DITË GËZIMI, MOMENT REFLEKTIMI!

NATA E KADRIT, PRESIDENTI META VIZITON MYFTININË E SHKODRËS



MBËSHTETJE PËR MBI 1000 FAMILJE SHKODRANE ME RASTIN E RAMAZANIT 1441/2020





Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

KRIZA E THELLË MORALE E NJERËZORE

Të gjithë duhet ta kundërshtojmë të keqen, ta refuzojmë atë, të mosbindemi para saj, të mos tolerojmë e të mos pranojmë erën e saj mbytëse, që e ka rritur dukshëm nivelin e smogut të zullumit e të dekadentes; ku nga djallëzia e prodhuesve dhe propaganduesve të saj, ku nga heshtja, përgjumja dhe bërja palë me realitetet e këtij modeli munkeri!

arsye që nuk e di se cila është, e që cilado që të jetë nuk e justifikon këtë shfaqje nga blutë në fjalë, aq më shumë në një ditë të shenjtë Ramazani! Dukej tamam si pamjet që vijnë nga shfaqjet barbare të policisë indiane me njerëz të pafajshëm që dhunohen e masakrohen rrugëve, pa pikë mëshire!

Përballja me “armikun” e padukshëm, që ka kapluar globin dhe që dita-ditës po nxjerr në pah të vërtetat e mëdha të kësaj që po ngjet kudo në botë, po na shfaq njëkohësisht edhe fytyra dhe portrete të shumta, që deri dje, nën efektin e makiashit, dukeshin ndryshe nga ç’duken sot, në imazhin e tyre të vërtetë e real!

Natyrshtëm, në këtë kontekst, lista është e gjatë dhe pak nga pak përfshin shumë prej nesh, sidomos ata që kanë një mision të lartë e të spikatur në shoqëri, por që shkelin mbi të pa të drejtë!

Nëpërmjet rrjeteve sociale ndoqa sot, një shfaqje terrori në mes të Tiranës, ku një grup policësh dhunojnë në mënyrë barbare një të ri, për një

Këta policë janë imazhi më i padenjë i një institucioni që duhet të ketë mbështetjen dhe bashkëpunimin e të gjithë atyre që i duan të mirën vendit; sigurisë, mirëqenies, rendit dhe normalitetit në marrëdhëniet e individit me ligjin! Por, në këtë rast, veprimi kriminal i tyre duhet të dënohet nga të gjithë ne, pa asnjë tolerancë!

Këta policë nuk përfaqësojnë ata qindra djem të nderuar, që me përkushtimin e tyre, vlerat e tabanit, profesionalizmin, qytetarinë dhe, mbi të gjitha me njerzillekun e tyre, japin një kontribut të shkëlqyer për të ngritur në piedestalin e merituar imazhin dhe rolin e ruajtës të rendit, sigurisë, paqes e

qetësisë në shoqëri!

Të tillët duhet të jenë pjesë e lutjeve tona ditore, që Zoti Fuqiplotë t’i ruajë e t’i japë mbarësi!

Polici a kushdo që terrorizon të riun tonë, që e godet atë barbarisht në mes të ditës e në mes të rrugës, që e shan dhe e përlulë atë publikisht, nuk bën të tolerohet, as të justifikohet, as të mbrohet nga askush!

Të gjithë duhet ta kundërshtojmë të keqen, ta refuzojmë atë, të mosbindemi para saj, të mos tolerojmë e të mos pranojmë erën e saj mbytëse, që e ka rritur dukshëm nivelin e smogut të zullumit e të dekadentes; ku nga djallëzia e prodhuesve dhe propaganduesve të saj, ku nga heshtja, përgjumja dhe bërja palë me realitetet e këtij modeli munkeri!

Pamje të tilla dëshmojnë krizë të thellë morale e njerëzore, që ka nevojë të menjëhershme për shërim e pastrim!

Shkodër, më 16 maj 2020

INSTITUCIONI I XHAMISË, SI FRYMËZUES I VETËDIJES SË SHOQËRIVE..!

Është mëse normale që të kërkohet lirimi i hapjes së xhamive, qoftë edhe me protokolle të caktuara, në shërbim të shëndetit dhe sigurisë, aq më tepër në kushtet e sotme, kur dalëngadalë, gjithandej nëpër botë po merren masa të tilla.

Nëse kjo ndodh, do të thotë se ka akoma shpresë e begati në shoqërinë tonë! Do të thotë se, dikujt i dhemb zemra për një të drejtë legjitime, nga e cila jemi privuar gjithandej nëpër botë, për shkaqe që janë bërë të ditura dhe të cilat janë pranuar nga elitat tona, duke dhënë udhëzimet e duhura, krejtësisht të drejta e të urta në raport me situatën kaotike të ditëve të para të panikut global.

Roli i institucionit të xhamisë, historikisht ka qenë vendimtar për të rrezatuar modele dhe shembuj, që edhe në rastin e pandemisë Covid 19 ka qenë në pozitë të udhëzuesit të urtë, pas

udhëzimeve të cilit, shoqëria ka reaguar me pjekuri dhe bindje. Historikisht institucioni i xhamisë ka qenë frymëzues i vetëdijes së shoqërive, sikurse prej aty kanë nisur edhe lëvizje të mëdha, që kanë rregulluar jo pak herë edhe ekuilibra të prishur në shoqëri!

Fakti që vende me numra të frikshëm në përballjen e tyre me pandeminë, kanë deklaruar lehtësime në qarkullimin dhe lirinë e njerëzve për t’iu kthyer jetës normale, përfshi edhe frekuentimin e objekteve fetare, e forcon edhe më shumë këtë kërkesë të natyrshe nga çdo besimtar.

Nga ana tjetër, nuk është aspak normale që të dëgjojmë dokëdo të flasë për moshapjen e objekteve të besimit, njëkohë që masat liuese po nisin edhe me hapjen e lokaleve.

Pa asnjë dyshim, duhet të dihet se është Ramazan dhe Ramazani ka shenjtëri! Nuk ka logjikë, as mund të

pranohet që në Muajin e shenjtë të mbarë botës islame, të lajmërohet hapja e lokaleve, por njëkohësisht të lajmërohet se nuk ka ndonjë plan për hapjen e objekteve të besimit, se përbëkan rrezikshmëri të lartë!

Ne nuk do të përballemi me mullinj të erës së dokujtudo, por njëkohësisht është morale, fetare e kombëtare të mos pranojmë që më të disiplinuarit me gjendjen e pandemisë dhe rregullat e saj të mos kenë trajtim në këtë fazë të masave liuese!

Dikush duhet të mendojë pak më thellë e më me qetësi, sikurse do të ishte dinjitoze që në këtë Muaj të Begatë, tëna kursehen deklaratat që nuk peshojnë asnjë gram në peshoret e logjikës dhe dinjitetit fetar e kombëtar!

Imam Muhamed B. Sytari

*Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, më 3 maj 2020*

NATA E KADRIT, PRESIDENTI META VIZITON MYFTININË E SHKODRËS

Me rastin e Natës së Kadrut, vlera dhe madhështia e të cilës përmendet qartë në Kur’anin Famëlartë, Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta, zhvilloi një vizitë të përzemërt në Myftininë e Shkodrës.

Presidenti i Republikës u prit nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, që pasi i uroi mirëseardhjen në Shkodër, e falënderoi Shkëlqesinë e Tij për këtë vizitë të veçantë në atmosferën e Muajit të Begatë të Ramazanit dhe Natës së Kadrut.

Myftiu theksoi se 2020-ta është viti jubilar i 30 vjetorit të rihapjes së aktivitetit fetar në Shkodër, pas rënies së diktaturës komuniste.

Me këtë rast, i dhuroi Presidentit të Republikës një tablo të tubimit madhështor të rihapjes së xhamisë së Plumbit, më 16 nëntor 1990.

Myftiu tha se, diktatura i shembi muret dhe objektet, porse nuk arriti të vriste dot shpirtin dhe besimin e njerëzve, që edhe pas dekadash nga



privimi i madh, ishin të gjithë së bashku në hapjen e xhamive dhe kishave në vend në nëntor të vitit 1990.

Nga ana e tij, Presidenti Meta shprehu mirënjohjen e tij për Myftiun dhe Myftininë e Shkodrës, për aktivitetin e larmishëm, për rolin vendimtar në përhapjen e harmonisë fetare e kombëtare dhe nxitjen dhe ruajtjen e paqes sociale, në bashkëpunim edhe me institucionet e tjera fetare në vend.

Njëkohësisht uroi besimtarët me rastin e Natës së Kadrut, sikurse vlerësoi

rolin e Shkodrës, prijësve fetarë dhe qytetarëve të saj në ruajtjen e besimit, si dhe vlerësoi rolin e spikatur në proceset demokratike të vendit

Pas pritjes në zyrën e Myftiut, Presidenti Meta vizitoi edhe xhaminë e Parrucës, ku u njoh edhe me historikun e saj dhe shprehu kënaqësinë e tij për rimëkëmbjen e institucioneve të besimit, që i shërbejnë komunitetit në praktikimin në liri të adhurimeve dhe lutjeve të tyre.

Me rastin e kësaj vizite, Myftiu shtroi edhe iftarin e kësaj Nate të Begatë.

MESAZH URIMI ME RASTIN E FITËR BAJRAMIT 1441/2020

Të dashur dhe të shtrenjtë, motra dhe vëllezër besimtarë!

Me këndimin e ezanit të akshamit të kësaj dite, mbarë bota islame, nga lindja në perëndim, hyn në atmosferën e begatë të muajit Shevval, që shënon edhe fillimin e ditës së parë të Fitër Bajramit, festës së shënuar për muslimanët e krejt botës.

Gjithandej njerëzit gëzojnë me Zotin e tyre, marrin dhe japin urime, lutje e shpresë, për një agjërëm të pranuar, për një muaj, hëna e të cilit i lë vendin hënës së festës e gëzimit, pas një lumturie, gëzimi e adhurimi të pashembullt, që na angazhoi të gjithëve për të shfaqur më të mirën nga vetja e jonë, në përgjigje të thirrjes hyjnore për të agjëruar me përkushtim e zemër!

Ditën e diel, më 24 maj 2020, që në orët e para të mëngjesit, të gjithë do të drejtohemi nga dyert e xhamive tona, për të dëshmuar bashkarisht faljen e Fitër Bajramit, për të marrë e për të dhënë urimet e zemrës me vëllezërit tanë, për të dëshmuar bashkarisht se, kur jemi bashkë si një zemër e vetme, çdo gjë është më e bukur, më shpresëdhënëse, më pranë devotshmërisë e më afër All-

llahut të Madhëruar, që na thërret për të qenë si një familje e madhe e besimit dhe vlerave.

Fitri i sivjetshëm na gjen në një situatë sprove, të cilën e kaluam me besimin dhe qytetarinë tonë, porse jemi të ftuar të mendojmë për skamnorët e nevojtarët, që ndoshta nuk e kanë mundësinë të festojnë si duhet në këtë ditë të gëzuar.

Resulull-llahu (a.s.) thoshte: “Nuk më ka besuar as edhe një moment të një dite, ai që shkon të flejë i ngopur, ndërkohë që komshiu i tij përbri është i uritur dhe, ai e di këtë!”.^[1]

Prandaj, le ta ndajmë gëzimin dhe dritën e kësaj dite të shënuar me njerëzit tanë, të pyesim e të interesohemi për ta, të shërojmë me sa të kemi mundësi skamjen dhe varfërinë, si dhe të dëshmojmë bashkarisht thirrjen e madhe: “Jetoni, o robër të All-llahut, si vëllezër!”.^[2]

Bajrami i madh dhe i vërtetë, është ai, që na mban të lidhur pas dritës së Krijuesit tonë! Bajrami i vërtetë është ai, që na mban të lidhur pas besës dhe madhësisë së adhurimit në Ramazan! Bajrami i vërtetë është ai, që na forcon edhe më shumë në rrugën e përkushtimit

dhe dashnisë së All-llahut të Madhëruar, i Cili urdhëron: “Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon, në mënyrë që ju t’ia vini veshin!”.^[3]

Le të shfrytëzojmë këtë kohë për t’i drejtuar zemrat nga thirrja e Zotit dhe për të dëshmuar besëlidhjen e madhe e të pathyeshme!

“Nëse të vjen një njeri me halle, dëgjoje! Po të erdhi dikush që të kërkon falje, fale! Po të erdhi një nevojtar, jepi! Prej teje nuk kërkohet të kesh një Mus’haf në xhep, porse të jesh ajet në mirësjelljen tënde!”.^[4]

Me zemër të mirë e me bekime, Fitër Bajramin!

Imam Muhamed B. Sytari

*Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, më 23 maj 2020
30 Ramazan 1441*

[1] Transmetuar nga Tabarani dhe Bezzari, nga Enesi (r.a.).

[2] Transmetuar nga Muslimi, nga Ebu Hurejra (r.a.).

[3] Kur’ani, En-Nahl: 90.

[4] Thënie e mendimitarit egjiptian, Dr. Mustafa Mahmud.

“ISLAMI IA RUAJTI BOTËS MBARË E SIDOMOS ASAJ TË SOÇMES TË MIRAT E MEJTIMIT NJERZUER”

Momentet e ditëve dhe netëve të shënuara janë një ftesë hyjnore për të reflektuar se kush jemi dhe sa peshojmë në peshoren e besimt dhe fetarizmit të shëndoshë, përtej vendit që i kemi caktuar vetes në realitetet e përditshme, me të cilat përballemi si individë, si komunitet e si shoqëri!

Bajramet janë më shumë se një festë e zakonshme, ku njerëzit mblidhen e festojnë në një mënyrë a një tjetër. Kjo është festë, që në vetvete mat pulsën e komunitetit, aftësinë për të qenë së bashku, nën një drejtim, pas një drite e një udhëzimi; burra e gra, pleq e fëmijë, të gjithë pa përjashtim, si për t'u parë në pasqyrën e njëri-tjetrit, si një e tërë, jo si copëza të pakuptimit të një puzzle-i, që nuk plotësohet, sado të lodhesh për t'ia mbledhur copëzat e tij!

“Bajrami, siç e kuptojmë, është mundësia që All-llahu i ka dhënë njeriut, për të nxjerrë në pah lartësinë e humanizmit të tij në sferën e vlerave, për të ndjerë, (tekta ndodhet në këtë atmosferë shpirtërore), vëllazërinë që e lidh me vëllanë e tij njeri në një gëzim jete, si dhe njësimin e plotë të ndjenjave..., deri aty, sat ë bashkohet më fëmijën e vogël në lojën e tij, me plakun e moshuar në gëzimin e tij dhe me të riun energjik në mallëngjimin dhe ndjenjat e tij.

Këtu e gjejmë kuptimin e vërtetë të transmetuar në hadithe të shumta që nxisin dhe pëlqejnë shtimin e vizitave, bamirësinë ndaj vëllazërisë, pajtimin në mes vete dhe të tjera metoda që tërheqin dashamirësinë dhe kthjelltësinë në ditët e bajrameve.”.¹

Gjatë kësaj periudhe shumëvjeçare, shumëkush në këtë vend është shpërftyrë, duke përbaltur fenë kryesore të këtij kombi, siç nuk e kanë zakon as burrat e urtë, as vizionarët, as burrat e shtetit, as dinjitarët, as prijësit e urtë fetarë, as drejtuesit largpamës.

Edhe në këtë Muaj të begatë kemi dëgjuar andej-këndej, aty e këtu, të

1. Es-Sejjid Muhammed Husejn Fadlull-llah, Kadajana ala douil-Islam, Darul-Melak, Bejrut, botimi i 7-të, 1996, f. 61.

pavërteta, cënime e keqtrajtime të imazhit të Islamit! Kemi heshtur e kemi vazhduar rrugën tonë. Jo se ne nuk dijmë të flasim e të kthejmë përgjigje...!?

Ne jemi muslimanë dhe muslimani është njeri me dinjitet, është krenar dhe nuk e kthen kokën saherë që dikush a diçka lëshon zë, sa djathtas-majtas!

Prandaj, ky është momenti për të pyetur se sa me vlerë ka qenë ky muaj për të rizgjuar tek ne ndjenjën e të jetuarit me dinjitetin e nënshtimit para Duarve të Krijuesit Fuqiptotë, duke mos pasur frikë për asgjë dhe duke u përpjekur me të gjitha forcat për të ndërtuar jetën me besim e vlera, duke rrezatuar mirësi e dritë, nga Drita e kësaj feje të

BAJRAMET JANË MË SHUMË SE NJË FESTË E ZAKONSHME, KU NJERËZIT MBLIDHEN E FESTOJNË NË NJË MËNYRË A NJË TJETËR. KJO ËSHTË FESTË, QË NË VETVETE MAT PULSIN E KOMUNITETIT, AFTËSINË PËR TË QENË SË BASHKU, NËN NJË DREJTIM, PAS NJË DRITE E NJË UDHËZIMI; BURRA E GRA, PLEQ E FËMIJË, TË GJITHË PA PËRJASHTIM, SI PËR T’U PARË NË PASQYRËN E NJËRI-TJETRIT, SI NJË E TËRË, JO SI COPËZA TË PAKUPTIMTA TË NJË PUZZLE-I, QË NUK PLOTËSOHET, SADO TË LODHESH PËR T’IA MBLIEDHUR COPËZAT E TIJ!?

madhnueshme islame, me të cilën na ka lartësuar Zoti i gjithësisë si komb, si shoqëri e si njerëz në mesin e njerëzve!

Momenti është që secili të shohë veten në pasqyrën e besimit, të pyesë se a është i drjetë rrugëtimi i tij në marrëdhënie me All-llahun e Madhëruar, me veten, me familjen, me shoqërinë e me atdheun dhe, hakun që ka secili në veten e tij!

A është koha që ne si muslimanë të zgjohemi nga gjumi i rutinave folkloriste, i besimit sipërfaqësor, i shprehjeve të një standarti të ulët, i angazhimit me çështje sipërfaqësore, që gati-gati na kanë kthyer si një imazh i paprekur i shembullit të beni israilëve, për të cilët flitet sa e sa në Kur’anin Famëlartë!

A nuk janë shumë prej realiteteve të bashkësisë dhe komunitetit tonë, të ngjashme me mendësinë e pyetjes për ngjyrën e lopës, për të cilën qenë

urdhëruar të bënin kurban beni israilët e Hz. Musait (a.s.): “Kujto kur Musai i tha kombit të vet: ‘Allahu ju urdhëron të thërn një lopë!’ Ata thanë: ‘A do të tallesh me ne?’ – ‘Zoti më ruajt!’ - tha Musai - ‘të bëhem unë nga të paditurit!’”. 68. Ata thanë: ‘Lutju Zotit tënd, që të na shpjegojë si duhet të jetë ajo!’. Musai tha: ‘Ajo të jetë një lopë as plakë, as e re, por e mesme; pra, bëni atë që ju është urdhëruar!’”. 69. Ata thanë: ‘Lutju Zotit tënd që të na shpjegojë çfarë ngjyre të ketë ajo!’. Musai tha: ‘Ai thotë se ajo duhet të jetë lopë me ngjyrë të verdhë të ndezur, të cilën e pëlqejnë shikuesit’. 70. Ata thanë: ‘Lutju Zotit tënd, që të na shpjegojë çfarë lloji të jetë, sepse lopët të gjitha na duken njësoj e ne, në dashtë Zoti, do të udhëzohemi në rrugën e drejtë’...”²?

Të dashur të pranishëm!

Në Kur’anin Famëlartë, lexojmë ajetin 41 të sures El-Haxh: “(Allahu i ndihmon edhe) ata, të cilëve, nëse u japim pushtet në tokë, kryejnë faljet, japin zekatin, urdhërojnë kryerjen e veprave të mira dhe pengojnë atë që është e mbrapshtë. Tek Allahu është fundi i të gjitha çështjeve.”.³

Ky është një ajet, që duhet të na tërheqë vëmendjen për të na zgjuar

nga gjumi i pasimit të verbër të çdo gjëje në jetë, sidomos, kur ajo ka për qëllim të prishë dalëngadalë lidhjet e forta që na mbajnë të lidhur me tabanin e besimit dhe fesë sonë.

A nuk e keni vënë re se, vit pas viti, në realitetet shqiptare dalin në pah bidate të reja, në emër të thirrjeve të shumta, që shpesh na detyrojnë edhe të vrasim mendjen për të nxjerrë fetva justifikuese për kazmat që në heshtje (dhe hutimthi, dhe ndoshta edhe me pakujdesinë tonë), vazhdojnë të punojnë pa asnjë merak?

Fjala bie: Në vitin 1937, Hoxha i mirënjohur shkodran, H. Sulejman Gavoçi, patrioti i biri i patriotit dhe Hoxhës së nderuar Hafiz Halil Gavoçi, (që luftuan në frontin e parë për mbrojtjen e Shkodrës nga sulmet malazeze të kohës), emigruan nga Shkodra drejt Damaskut.

2. Kur’ani, El-Bekare: 67-70.

3. Kur’ani, El-Haxh: 41.

Të njëjtën gjë bënë edhe disa familje të nderuara, prej të cilave do të dilnin më pas dijetarët e shquar arnautë të ymetit tonë.

Por, cili ishte shkaku i emigrimit?

“Zogu i ngratë kishte nxjerrë një ligj që ndalonte mësimin e fesë nëpër shkolla. Një gjë e tillë kishte ndikuar për keq edhe tek kurset private, kështu që nana ime më kishte qepur një xhep të brendshëm në këmbishën time, në të cilën të fusja Ilmihalin dhe kështu çdo ditë shkoja në kursin e mësimi të fesë në xhaminë Plakë, duke u ruajtur nga xhandarët...”⁴ – dëshmon Hoxha i jonë, Shejkh Vehbi S. Gavoçi.

“Baba, pasi pa se gjendja e vendit tonë po prishej dita-ditës, vendosi të largohej nga vendi dhe të emigrojë...”⁵

Nga ajo kohë e deri më sot, dozat e ciflosjes janë shtuar, deri në atë pikë sa, kujtoj para ca vitesh Avokatin e Popullit që kërcënonte me burg njërin prej imamëve të njohur të Tiranës, nëse imami do të lexonte e predikonte ajetet e popullit të Lutit (a.s.), që sipas logjikës së avokatit të popullit të Lutit, çenonte të drejtën e tyre dhe bëhej shkak për racizëm.

Sot, dëgjojmë e lexojmë që abuzimi me muslimanët dhe emrin e institucionit të tyre është bërë edhe mjet satiristik, me të cilin politikanët e vendit gjuajnë njëri-tjetrin!

Mirëpo, a nuk duhet t’i vihet kufiri kësaj gjendjeje? Është shumë vonë madje, por si? Me fjalë? Me ligjërata? Me peticione? Me votë? Me heshtje? Me injorim? Apo me çfarë?

Të dashurit e mi!

Ajti 41 i sures El-Haxh vetëm se na jep esencën e zgjidhjes së kësaj katrahure, ku janë përfshirë muslimanët e kësaj shoqërie, të hutuar dhe të përçarë, falë edhe indoktrinimit aktiv, pas vitit 1990, me modele pa ngjyrë e shije të një modeli thuajse agresiv, të paditur, fanatik dhe ngatërrestar të një feje, që më shumë se përmbledhje fetvashë devijante e arsyetimesh të skaduara, nuk është asgjë tjetër; indoktrinim që ka prekur mbarë ymetin!

Në tefsirin e këtij ajeti lexojmë se: “Zoti ynë i Madhëruar përshkroi këta besimtarë të përkrahur, se janë ata që u është dhënë mbizotërimi në tokë, por çfarë është ai? Njeriu në tokë, ose mund të jetë mbizotërues me pushtet, ose i dobësuar.

4. Muhamed Sytari, Vehbi Sulejman Gavoçi – dijetar nga dijetarët e ymetit, Dituria Islame, Prishtinë, 2005, f. 20.

5. Po aty, f. 20.

LE TË FESTOJMË SOT, ME MIRËSITË E ALL-LLAHUT, LE TË GËZOJMË PËR MUNDËSINË E MADHE QË NA U DHA PËR TË AGJËRUAR RAMAZANIN E PLOTË DHE, LE TË LUTEMI QË AJO QË KALOI, MOS TË NGELET THJESHTË NJË SHFAQJE PA EFEKT E NJË ADHURIMI FORMAL!

I dobësuar është ai që nuk ka forcë për realizimin e qëllimit të tij, as e ka mundësinë për ta bërë një gjë të tillë, sepse është i dobët, i poshtëruar! Ndërsa mbizotërues është ai që ka mundësi të realizojë atë që do...

Mbizotërimi është njëkohësisht edhe sprovë. A thua vallë urdhëron për mirë dhe ndalon të keqen, pasi All-llahu e ka lartësuar (pra, ia ka dhënë mundësinë)? A thua e përkrah të vërtetën dhe refuzon të kotën? A i nënshtrohet të fortit në kurriz të besimtarëve?

Është sprovë, sepse besimtarit nuk ia shton pasuria, vetëm se thjeshtësinë, sikurse nuk ia shton forca, vetëm se bindjen ndaj All-llahut të Madhëruar. Ndërsa munafiku (hipokriti) po u pajis me pushtet në tokë, do të përhapë në të devijim e shkatërrim, do të nxisë fesad...

Muslimanët, kur ishin në Andaluzi, All-llahu i dha pushtet në shumë vende. Kur ata e falën namazin, e dhanë zekatin, urdhëruan për të mirë dhe ndaluan të keqen; All-llahu e bëri mbizotërues pushtetin e tyre, i përkrahu me forcë nga ana e Tij, i bëri të përhapen gjithandej nëpër Europë, derisa mbërritën në rrethinat e Parisit...”⁶

Në vitin 1939, në revistën zyrtare të Komunitetit Mysliman Shqiptar, lexojmë: “Po t’iu mbahet njeriu pikë për pikë parimeve islame e po të veprojë mbrenda kufive të tyre do të gëzojë jetën dyfishe, për sa i përket lumturisë: jetën material dhe atë shpirtnore. Nga parimet e pa lujtëshme të tij, Islami vrapoi me hapa më të shpejtë e të sigurta tue ndriçue botën mbarë, me një përparim të ri, mirësitë e të cilit njerzija vazhdon t’i shijojë në çdo kohë evolucioni.

Islami ia ruajti botës mbarë e sidomos

6. Dr. Muhammed Ratib En-Nabulsi, Tefsirun-Nabulsi, Muessetul-Fursan, Aman, 2016, botim i parë, vëll. 5, f. 554-555.

asaj të soçmes të mirat e mejtimit njerzuer: të mendimit grek, hindian dhe persian. Pra, anuk ishte Islami ky që na çoi në pregatitjen e të gjitha mirsinave të përparimit modern? Pse pra t’akuzohet Islami që gjoja është shkak dekadence e mbrapshtimi për bijt e tij e t’atyre që e ushtrojnë?!

Tashti për tashti do të mjaftojmë t’a cekim shumë pak këtë fenomen, për të qartësuar se dekadencia e popujve myslimanë i kthehet shkaqeve politike e shoqërore. Nuk i referohet aspak përshtypjes së dogmës ose të fesë... Prandaj, është shumë lehtë për myslimanët të ka[en prapë për origjinën e fesë së tyre; e për këtë iu mjafton të heqin dorë prej gjërave që s’pajtojnë me Ligjet Hyjnore; t’a hedhim poshtë vesin e të keqen e t’i zëvendësojmë ato me virtytin e të mirën.”.⁷

Të dashur besimtarë!

Në kryeveprën e tij me titull: “Çfarë humbi bota me dekadencën e muslimanëve”, dijetari i shquar islam Ebul-Hasen En-Nedevi, thotë se bota sot, ka nevojë për botën islame, që e drejton Hz. Muhammedi (a.s.) me misionin e tij të përgjeshëm dhe fenë e tij të urtë!

Shkruan: “Është e drejtë e botës islame të përgatisë veten për këtë përgjegjësi të rrezikshme dhe të ketë ambicie për të! Është e drejtë e çdo vendi islam dhe çdo populli musliman të lidhë vullnetin e tij për këtë! Sikurse është e drejtë e çdo muslimani të sakrifikojë në rrugën e këtij qëllimi, si dhe të japë atë që ka për mundësi, sepse kjo është përgjegjësia e lartë, që e karakterizoi ymetin islam, që ditëm që u shfaq në këtë ekzistencë dhe nga dita, kur fara e tij u shfaq në gadishullin arab!”.⁸

Le të festojmë sot, me mirësitë e All-llahut, le të gëzojmë për mundësinë e madhe që na u dha për të agjëruar Ramazanin e plotë dhe, le të lutemi që ajo që kaloi, mos të ngelet thjeshtë një shfaqje pa efekt e një adhurimi formal!

All-llahu i Madhëruar ju dashtë dhe ju pasë në mbrojtjen e Tij!

Me zemër të mirë e bekim Fitër Bajramin!

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

(Ligjërata me rastin e Fitër Bajramit, më 24 maj 2020, në xhaminë e Parrucës)

7. DREJTIMI, Të ndershëm lexuesë, në revistën Kultura Islame, Tiranë, viti I, shtator, 1939-XVII (Shaban 1358), nr. 1, f. 10.

8. Ebul-Hasen En-Nedevi, Madha khasirel-alem binhitatil-muslimine?!, Ed-Darush-Shamijje, Bejrut, botimi i parë, 1999, f. 271.



Prof. dr. Mehmet Gormez

Njeriu dallon nga krijesat e tjera falë aftësisë së tij për të menduar dhe medituar. Ai është pjesë e një bote krijesash të panumërta, mirëpo mundësia e të kuptuarit dhe të lexuarit drejt kësaj bote, i përket vetëm njeriut.

Sipas këndvështrimit islam ndaj universit, ekzistenca është një fushë meditimi me të gjitha manifestimet dhe dimensionet e saj. Kurani Fisnik flet për “vargjet-ajetet” të cilave duhet t’u qasemi si një dimension i këtij meditimi: “Ky (Kuran) është një libër i bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (Muhamed), për të përsiatur mbi vargjet e tij dhe për t’u këshilluar me të mendarët.” - (Kur’ani, Sad: 29)

Çdo kuptim i fjalës hyjnore i shprehur në rreshta është një ajet-argument (ajat-i mestura), ashtu siç është edhe vetë universi (ajat kevnije), po qe se do vështrohej me syrin e duhur. Këto ajete-shenja të cilat janë udhëzues drejt të vërtetës, janë pjesë e botës së jashtme (afaki) dhe botës së brendshme (enfusi) të njeriut. Kjo ndarje e ajeteve shprehet qartazi nga Krijuesi Fuqiplotë: “Ne do t’u tregojmë atyre shenjat Tona në hapësirat tokësore e qiellore, si dhe në vetvete..” - (Kur’ani, Fussilet: 53)

Allahu i Lartësuar na fton të meditojmë rreth krijimit të përsosur në univers duke u shprehur: “Ai ka krijuar shtatë qiej njërin mbi tjetrin. Nuk mund të gjesh në

MEDITIMI

krijimin e të Gjithëmëshirshmit kurrfarë kontrasti. Hidhe vështrimin: a sheh ndonjë plasaritje? Pastaj hidhe sërish vështrimin; sytë e tu do të kthehen të lodhur e të molisur.” - (Kur’ani, El-Mulk: 3-4)

Për ata që mendojnë, universi në tërësi është argument i ekzistencës së Allahut, i njësisë, mençurisë dhe fuqisë së pakrahasueshme të krijimit të Tij. Nga ky këndvështrim, nuk është rastësi fakti që fjala alem (botë) dhe fjala alamet (shenjë) rrjedhin nga e njëjta rrënjë.

Historia dhe gjeografia janë dy tregues të qenësishëm që vënë në dukje (që orientojnë drejt) koordinatat e ekzistencës. Kjo është arsyeja pse; Kurani Famëllartë, nga njëra anë, zbulon ngjarjet historike që janë pikë kthese për njerëzimin në formën e tablove që duhen marrë shembull dhe nga ana tjetër, tërheq vëmendjen tonë drejt mjedisit natyror dhe gjeografik ku jetojmë.

Po kështu, një formë tjetër meditimi që Kurani na orienton është edhe udhëtimi nëpër botë për të vëzhguar gjurmët e popujve të kaluar: Thuaj: “Udhëtoni nëpër botë e shihni çfarë dënimin kanë marrë ata që përgënjeshtrojnë (të dërguarit). - (Kur’ani, el-En’am: 11) Përfitimi prej një udhëtimi që mund të shtrihet në një hapësirë kohore të kaluar apo në një vend, është i lidhur ngushtë me mesazhin dhe mësimin që merr udhëtari. Nga ana tjetër, rrugëtimi që njeriu ndërmerr në botën e tij të brendshme (enfus) për të hapur perdet e së vërtetës, është një meditimi i thellë që lartëson shpirtin e tij.

Meditimi, është një nga konceptet themelore më të rëndësishme të traditës së shkencës islame. Kështu thellimi dhe meditimi rreth ajeteve kuranore, ka sjellë më vete lindjen e shkencave fetare, si: tefsiri, fik’hu, kelami, duke krijuar natyrshëm një pasuri shkencore të pakrahasueshme. Ndërsa meditimi i thellë mbi univers çoi në shfaqjen e shkencave

natyrore dhe i hapi rrugën krijimit të një literature shumë të pasur në këtë fushë.

Meditimi në botën e brendshme njerëzore, krahas shkencave të ndryshme, si: psikologjia apo etika, ka rezultuar në formimin e një tradite kulturore që e ka pasuruar edhe më tepër shpirtin tonë. Njeriu arrin mençurinë për sa kohë sodit vetveten. Një njeri që llogarit, kontrollon dhe mbron vetveten, mund të arrijë të përsosë mendimet, fjalët dhe veprimet e tij.

Në fakt, adhurimi apo shërbimi që nuk është kulluar në filtrin e meditimit, nuk mund të jenë frytdhënës, ashtu sikurse nuk mund të jetë frytdhënës fjala e pamenduar. Hapat e hedhur pa ndriçuar mendjen dhe pa pastruar shpirtin janë thesht hapa kuturu. Nga ana tjetër, ata që e shohin meditimin vetëm si një mjet drejt diturisë dhe nuk e kthejnë atë në një tipar të natyrshëm, nuk mund të kenë dobi prej saj, as për vete dhe as nuk mund t’u bëjnë dobi të tjerëve.

Në këtë këndvështrim, ne kemi nevojë të mendojmë dhe të meditojmë më thellë në lidhje me rutinën tonë të përditshme në mënyrë që t’i japim kuptim tjetër punës, jetës dhe adhurimit tonë. Duhet të kuptojmë se detyra jonë si thirrës në rrugën e Zotit, përveç se një profesion është një trashëgimi e çmuar profetike ndaj së cilës duhet të sillemi me besnikëri dhe përkushtim. Nga ana tjetër, në këmbim të aftësisë sonë për të menduar duhet ta falënderojmë Krijuesin Fuqiplotë.

Vlen të kujtojmë shprehjen e Hz. Aliut (r.a.): “Dy lloj njerëzish më shqetësojnë Njeri është dijetari i shkujdesur ndaj asaj që zotëron me diturinë e tij, tjetri është i padituri që jepet pas devotshmërisë.”

Me shpresën që ta mbajmë dritën e mendjes në pasqyrën tonë të zemrës dhe ta reflektojmë atë në jetën tonë ...

Përktheu nga turqishtja:
Elona SYTARI

SJELLJA E MEHMET FATIHUT ME TË KRISHTERËT E MUNDUR TË KOSTANDINOPOJËS

“Sulltani u dha liri krishterëve për të mbajtur simbolet e tyre fetare dhe të drejtën e zgjedhjes së udhëheqësve të tyre fetar, të cilët kishin të drejtë të gjykonin në çështjet qytetare.

Këtë të drejtë ua dha edhe njerëzve të kishës në krahinat e tjera, por në të njëjtën kohë ua obligoi që të gjithëve haraçin (pagesën e xhizjes).

Historiani anglez Eduard Sheperd Kris në librin e tij “Historia e turqve osmanë”, për shkak të zilisë dhe urrejtjes që ka ndaj çlirimit të lavdishëm islam, u përpoq ta njollosë realitetin e çlirimit osman të Kostandinopojës, duke e përshkruar Sulltan Mehmet Fatihun me cilësi jo të mira.

Edhe “Enciklopedia Amerikane” e botuar më 1980 g. u ndikua nga shpifjet e urrejtjes kryqtare kundër Islamit dhe pretendon se Sulltan Mehmeti i robëroi shumicën e të krishterëve të Kostandinopojës, e pastaj i dërgoi në treg të robërve në qytetin Ederne për t’i shitur.

Realiteti i pastër historik thotë: Sulltan Mehmet Fatihu i trajtoi banorët



e Kostandinopojës me mëshirë, i urdhëroi ushtarët të sillen mirë me ta dhe t’i trajtojnë butësisht të burgosurit. Shumë prej të robëruarve i liroi duke paguar me pasurinë e tij personale, e veçanërisht princërit e Greqisë, njerëzit e fesë. U takua me peshkopët, ua zbuti frikën dhe i qetësoi duke iu garantuar se do t’ua ruajë besimin, simbolet dhe objektet e tyre të adhurimit. ... Trajtimi i të krishterëve ishte i zhveshur nga çdo formë e fanatizmit dhe padrejtësisë. Osmanët asnjëherë nuk kanë menduar t’u bëjnë trysni të krishterëve për shkak të fesë së tyre.

Shfaqja e faljes dhe tolerancës nga ana e Sulltanit Mehmet Fatihut ndaj të krishterëve të Kostandinopojës, nuk ishte tjetër veç se shtytje nga zbatimi i Islamit Madhështor, duke pasuar Pejgamberin Fisnik (a.s.) dhe kalifët e udhëzuar pas tij, faqet e historisë së të cilëve janë të mbushura me falje, tolerancë dhe fisnikëri ndaj armiqve.

- Dr. Muhammed Ali Salabi,

“Perandoria osmane, faktorët e ngritjes dhe rënies së saj”, përkthyer në shqip nga Bahri Curri, Jahja Hondozi dhe Behxhet Behrami, botuar nga Sh.B. Fjala e bukur, Prishtinë, 2009, f. 129-130.

FERMANET SULLTANORE DËSHMI TË TOLERANCËS NDËRFETARE NË SHTETIN OSMAN

“Perandoria Osmane si shtet multietnik, multifetar, multi gjuhësor dhe kulturor i kushtoi vëmendje të posaçme bashkëjetesës, mirëkuptimit dhe harmonisë midis nënshtetasve të saj.

Fermanet sulltanorë mendoj se janë një dëshmi e pakontestueshme që tregojnë qartë që megjithëse shteti osman ishte në pozitat e sundesit, tregoi interesimin dhe tolerancën e duhur ndaj nënshtetasve të vet të besimit jo musliman.

Kjo politikë e ka zanafillën e saj që kur Sulltan Mehmeti i 2-të sapo pushtoi Stambollin i njohu Patrikanës Ortodokse pamvarësinë dhe lirinë e ushtrimit të riteve fetare.

Pas rënies së Stambollit, nga vendet përreth erdhën shumë të deleguar për të përgëzuar Mehmetin e 2-të për fitoren. Në këtë kohë erdhi edhe Patriku Grek i



Jeruzalemit, Atanasjas, me priftërinjtë për t’i kërkuar liritë e tyre.

Për këtë arsye Mehmeti i 2-të nxorri një ferman me anë të të cilit ndalonte çdo njeri që të përzihej në ritet, kishat dhe vendet e tyre të pelegrinazhit.

Tolerancën e shtetit Osman ndaj

popullsisë dhe grupeve jo muslimane e tregon edhe fakti që emrat dhe fetë e vendeve ballkanike vazhduan të egzistonin gjatë gjithë sundimit Osman.

Osmanët i kishin njohur edhe zyrtarisht besimet fetare të popujve të këtyre vendeve. Shteti osman ishte i vetmi organizëm politik i cili në periudhën mesjetare dhe më vonë i kishte njohur zyrtarisht tri fetë monoteiste (islame, krishtërimin, judaizmin) dhe bëri të mundur bashkëjetesën në harmoni të tyre dhe të nëngrupeve etnike dhe fetare.”

- Dr. Nezir Bata (Universiteti i Tiranës), “Fermanet sulltanore dëshmi e tolerancës ndërfetare në shtetin osman”, botuar në përmbledhjen me titull: “Nga perandoria osmane në Shqipëri e shkruam historinë me tolerancë...”, botim i TIKa, Tiranë, 2005, f. 66.

A I KA KRIJUAR SHTATË QIEJ NJËRIN MBI TJETRIN. NUK MUND TË GJESH VËSHTRIMIN: A SHEH NDONJË PLASARITJE? PASTAJ HIDHE SËRISH VËSHTRIMIN; SYTË E TU DO TË KTHEHEN TË LODHUR E TË MOLISUR.” - (KUR’ANI, EL-MULK: 3-4)



Msc. Zamira Puka (Bushati), teologe

RAMAZANI, FTESË PËR REFLEKTIM DHE RISISTEMIM TË PRIORITETEVE

Edhe muslimanët në mbarë globin janë pjesë e kësaj situate dhe të masave të marra ndaj kësaj pandemie dhe janë pjesë e kësaj sprove, ku përveç të tjerave po përjetojnë edhe mbylljen e xhamive. Por, ndryshe nga shumë njerëz të tjerë, muslimanët janë të vetëdijshëm se edhe kjo sprovë ashtu siç çdo gjë tjetër kudo në botë, nuk ndodh vetëm me caktimin e Allahut.

Por, subhanallah, në kulmin e kësaj hutie e paqartësie, muslimanëve iu vjen një thirrje nga Zoti i madhëruar, e cila thotë: “O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.” - (Kur'ani, El-Bekare: 183)

Subhanallah! Ky ajet, kjo ftesë na tregon për ardhjen e një mysafiri të shumëpritur, muajit të madhërueshëm të Ramazanit.

Subhanallah! Çfarë rahmeti?! Çfarë lehtësimi?! Sikur ky Ramazan na thotë se përtej asaj që shihni, përtej asaj që prekni, mos u shqetësoni, mos u brengosni, mos u hutoni sepse ju jeni përtej kufijve të kësaj Dynjaje. Jeni përtej telasheve të virusit. Çdo gjë ka për të shkuar në vend, si me shëndetin, punën, pasurinë ashtu edhe me çdo avari tjetër! Ky Ramazan sikur na thotë: “Shijojeni mëshirën, mirësitë dhe begatitë e pafundme të Allahut në këtë muaj!” Të gjithë jemi të vetëdijshëm se Allahu çdo gjëje i ka përcaktuar një afat të caktuar dhe se çështja e Zotit ka për të shkuar në vend.

Ardhja e këtij muaji në mes të kësaj sprove për muslimanët reflekton dhe jep

siguri, shpresë, ushqim për shpirtrat, triumf ndaj kësaj sprove, por edhe shpërblim për durimin që tregojmë ndaj pasojave të saj.

Kjo thirrje për agjërim, jo vetëm që ndryshon rutinën e përditshme por shkund edhe ndryshkun që mund të kemi zënë. Na zgjon nga gjumi i neglizhencës, i shpërdorimit të kohës në gjërat e pavlera dhe të kota. Na fton të reflektojmë ndaj shumë e shumë veprimeve, zakoneve dhe gjërave që bëjmë, nëse janë të duhurat apo jo?! Na fton të risistemojmë prioritetet tona sipas rëndësisë së tyre duke u bazuar në udhëzimet dhe mësimet e Kurani dhe të Profetit (a.s).

Mirësitë e muajit të Ramazanit, sado të mundohemi t'i shpjegojmë, nuk do të na mjaftonte as koha dhe as vendi sepse këto mirësi arrihen dhe përjetojnë vetëm me anë të praktikimit të agjërit.

Gjithashtu, ne duhet të dimë, të kuptojmë dhe të realizojmë qëllimin kryesor dhe më madhor të agjërit, i cili është “devotshmëria”. Po nuk kuptuam dhe realizuam këtë qëllim, atëherë nuk kemi përfituar ashtu siç duhet nga ky muaj dhe nuk mund të flasim për risistemim të prioriteteve tona. E shpjeguar shumë thjesht, devotshmëria është qëndrimi i duhur i njeriut ndaj hyjnore, që do të thotë dashuri e përkushtim ndaj urdhrave të Allahut dhe drojë nga dështimi ndaj tyre. Me anë të devotshmërisë besimtarët përvetësojnë vlerat sublime të shpalljes dhe zhvillojnë karakterin e tyre. Kjo gjë na përkujton dhe na fton që praktikat

fetare nuk duhet t'i shndërrojmë në një grup ritualesh të verbra, të kryera në nivelin e lëvizjeve fizike por duhet të jenë gjithmonë të ndërgjegjshëm, se ata kanë si qëllim ngritjen morale dhe shpirtërore:

Muslimani duhet të jetë i vetëdijshëm se Zoti i vlerëson gjërat me standarde dhe kriteret e ndryshme nga standardet dhe kriteret e njerëzve. Profeti Muhamed (a.s) në një hadith të transmetuar nga Ebu Hurejra, thotë: “Me të vërtetë Allahu nuk shikon as trupat dhe as fizionominë tuaj. Në të vërtetë Ai shikon zemrat e juaja.” - (Muslimi)

Kështu që tek Zoti, njerëzit nuk peshojnë me peshën e tyre fizike, por me peshën e ndjenjave dhe vlerave që mbartin. Njerëzit nuk vlerësohen tek Zoti me rrobat e shumta dhe të shtrenjta që kanë, por me rrobën e devotshmërisë. Ata nuk vlerësohen me pasurinë materiale që kanë në duart e tyre, por me pasurinë shpirtërore që mbajnë në zemrat e tyre dhe me atë pasuri që shpërndajnë për hatër të Zotit. Edhe vendet nuk vlerësohen tek Zoti thjesht nga bukuria e tyre, por me kujtimet që ata mbajnë në memorien e tyre. Kështu ndodh edhe me ditët dhe muajt. Edhe Ramazani, muaji të cilin e zgjodhi Allahu (xh.sh), vlerësohet për shumë gjera, por në veçanti, për obligimin e agjërit, i cili në vetvete mban shumë sekrete, është shumë specifik dhe shumë madhështor sepse ai i dedikohet vetëm Allahut xh.sh.

Një nga problemet e njeriut, ka qenë dhe vazhdon të jetë problemi i prioriteteve, nga t'ia nisim, cilin prioritet të vendosim më përpara, etj.

Rregulli parësor në vendosjen e prioriteteve është rëndësia që ato kanë dhe mbartin në jetën tonë. Por shpeshherë, nga arsye dhe shkaqe të ndryshme, këto prioritete nuk i vendosim sipas radhës së duhur të tyre, ose ndodh që të mbivendosim më pak të rëndësishmet mbi më të rëndësishmin, e kështu me rradhë. Sipas etapave të jetës sonë disa prioritete ndryshojnë nga njëri person te tjetri, por disa të tjerë janë të njëjtë për shumicën e njerëzve. Këtu do ndalem dhe do përmend disa nga prioritetet më kryesore për të gjithë. Ku, edhe ky muaj i madhëruar sikur i jep kuptimin real këtyre prioriteteve.

Prioriteti parësor i njeriut në jetë duhet të jetë të qenurit “rob i Zotit”. Agjërimi me veçoritë dhe specifikën e tij, sikur rizgjon tek muslimani ndjenjën e të qenurit “rob i Zotit”, duke i dhënë

Muslimani duhet të jetë i vetëdijshëm se Zoti i vlerëson gjërat me standarde dhe kriteret e ndryshme nga standardet dhe kriteret e njerëzve. Profeti Muhamed (a.s) në një hadith të transmetuar nga Ebu Hurejra, thotë: "Me të vërtetë Allahu nuk shikon as trupat dhe as fizionominë tuaj. Në të vërtetë Ai shikon zemrat e juaja."

lirinë nga çdo gjë tjetër përveç Zotit. Në vetvete të qenurit “rob i Zotit”, të jep lirinë absolute dhe të liron nga çdo robëri tjetër ndaj çdo krijese. Të qenurit rob i Zotit është prezantimi më i lartë që mund t'i bëhet njeriut sepse edhe Pejgamberi ynë Muhamedi (a.s) ka preferuar si epitet të tij “rob dhe i dërguar i Zotit”, Të jesh rob i Zotit do të thotë të kryesh funksionin e qëllimit të krijimit tonë, funksionin e “mëkëmbësit të Zotit në tokë”.

Kështu që edhe agjërimi na rikujton dhe na mundëson që të jemi më tepër të vetëdijshëm për ekzistencën e Zotit dhe na bën që të përjetojmë këtë ndenjë duke braktisur ushqimin dhe shumë gjëra të tjera vetëm për hatër të Zotit, gjë që tregon edhe kulmin e sinjeritetit tonë ndaj urdhrave të Tij. Dijetari i shquar Muhamed Gazali thotë: “Agjërimi është një obligim i vështirë, por rrënjës tek njeriu ideale të larta, i nxit të kryejnë vepra të mira dhe të largohen nga çdo e keqe. Agjërimi i mëson njeriut të vlerësojë dhe shpresojë vetëm atë që është e lëndueshme dhe të heqë dorë nga ajo që është e ulët. I mëson si të jetë i gatshëm dhe i shpejtë për të kryer atë vepër, që e kënaq Zotin e tij dhe të braktisë gjithçka, që bëhet shkak për zemërimin e Tij”.

Me anë të ndryshimit të rutinës së përditshme, agjëruesi arrin të përjetojë edhe shijimin e vlerave të namazit. Për shembull, gjatë Ramazanit është më se normale që besimtari ta intensifikojë ibadetin, sepse asnjëri nuk e di se a do të ketë rast që edhe vitin tjetër të arrijë muajin e Ramazanit. Përveç

namazeve ditore që falë rregullisht, një ndër namazet më të dashura tek Zoti është edhe namazi i natës. Me ngritjen në syfyr, i jepet mundësia dhe e ka më të lehtë faljen e namazit të natës, qoftë edhe dy rekate. Kjo gjë shumë muslimanëve, të cilët nuk e kishin praktikuar më parë, i mundëson përjetimin e emocioneve të tij dhe bëhet shkak që ata, ta vazhdojnë faljen e namazit të natës edhe pas Ramazanit.

Gjatë Ramazanit mundohemi që të jemi sa më kreativ, ku përveç gjërave të domosdoshme në ditët tona, mundohemi të bëjmë sa më shumë vepra të mira dhe sa më të ndryshme. Si për shembull shtrimi i iftareve, dhënia e sadakasë, leximi i Kuranit, dëgjimi i ligjëratave fetare, solidariteti me njerëzit në vështirësi, etj. etj. Disa prej këtyre veprave mund t'i vazhdojmë edhe pasi të kalojë Ramazani duke i bërë pjesë të përditshme të jetës sonë.

Kushedi sa orë të panumërta kemi kaluar duke debatuar me të tjerët, duke u përplasur dhe duke u zhytur në debate e polemika pafund, duke u rrekur ta bindim tjetrin për vërtetësinë e këndvështrimit tonë dhe gabimin e këndvështrimit të tij, duke besuar se po e bëjmë për hir të vërtetës. Por, në fakt, shpeshherë kemi nxitur dhe fituar urrejtjen ndaj njëri-tjetrit. Teksa jemi agjërueshëm, normalisht, nuk kemi aq fuqi të debatojmë, ne mundohemi t'i largohemi me aq sa mundemi debateve të kota dhe mundohemi të flasim një gjuhë tjetër, atë të zemrës. Duke qenë agjërueshëm, sikur trajnohemi që të flasim duke u menduar mirë dhe të disiplinojmë gjuhën e të largohemi nga thashethemet.

Pra, agjërimi na konfirmon edhe njëherë se mund t'ia dalim pa asgjë tjetër, përveç Zotit, se lidhja jonë me ushqimin, pijen dhe me gjërat e tjera, nuk janë lidhje vendimtare. Në fakt, ato janë thjesht mekanizma që duhet ti shërbejnë qëllimeve më madhore. Ai na pohon dhe na vërteton mundësinë e lartësisimit dhe kapërcimit ndaj shumë veseve, por, vetëm me një kusht, që gjithçka të bëhet për hatër të Zotit dhe në kërkim të kënaqësisë së Tij.

Lus Allahun të na bëjë të qëndrueshëm në fenë tonë, të na e bëjë të dashur imanin, të na e bëjë të lehtë ndjekjen e Islamit dhe të na bëjë të përfitojmë nga mirësitë e begatitë e pafundme të muajit të Ramazanit.

“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.”

- (Kur'ani, El-Bekare: 183) -

OMANI, OSE “SULTANATI I OMANIT”

Omani, ose zyrtarisht “Sultanati i Omanit”, është një vend arab i vendosur në pjesën juglindore të Gadishullit Arabik, me një sipërfaqe prej 309.500 km², dhe një popullsi prej 5.093.172 banorësh, sipas worldmeters^[1].

Sultanati i Omanit rrethohet nga tre dete: Deti Arab, Deti i Omanit dhe Gjiri Arabik, dhe vija bregdetare e tij shtrihet 3.165 km e gjatë, nga ngushtica e Hormuzit në veri, e deri në kufirin me Jemenin në jug-perëndim.

Sultanati i Omanit kufizohet me Emiratet e Bashkuara Arabe në anën veri-perëndimore, me Mbretërinë e Arabisë Saudite në perëndim, me Republikën e Jemenit në jug-perëndim; në jug deri në lindje kufizohet me Detin Arabik, kurse në veri me Gjirin e Omanit. Një pjesë të vogël të territorit të Omanit e zënë Ra'sul -Xhibāl (majat e maleve), që gjenden në majën veriore të Gadishullit Musendem të Omanit, në ngushticën e Hormuzit, dhe ky territor i jep Omanit frontin e tij të vetëm në Gjirin Arabik. Territoret e tij në det të hapur përfshijnë ishullin Masirah në lindje, dhe ishullin El-Halānija, i cili gjendet 40 km larg bregdetit jugor.

Pjesa më e madhe e brendshme e territorit të vendit shtrihet në zonën e njohur si Rub' El-Khali të Gadishullit Arabik, që mbulohet nga shkretëtira, e karakterizuar nga mungesa e ujit dhe e bimësisë.

Ndryshe nga territori i ashpër i zonës së brendshme të vendit, rajonet bregdetare janë shumë më “mikpritëse”. Bregdeti i harlisur verior i Omanit, shtrihet midis detit dhe maleve të brendshme. Ky rajon i gjelbëruar dhe pjellor, është i njohur për prodhimin e rrushit dhe të prodhimeve të tjera, siç është edhe rajoni Dhufar në jug të vendit.

Qyteti i Muskatit, që është edhe kryeqyteti i vendit, shtrihet përgjatë bregdetit verior. Duke ndërthurur arkitekturën moderne dhe tradicionale, qyteti vështron nga Gjiri i Omanit, dhe shërben si një port dhe qendër tregtare. Historikisht, Muskatit ka qenë porti kryesor tregtar në rajonin e Gjirit Arabik, e gjithashtu një ndër portet më të rëndësishme tregtare në oqeanin Indian^[2].

Nga fundi i shekullit të 17-të, Omani ishte një perandori e fuqishme, që garonte me Mbretërinë e Bashkuar dhe Portugalinë për ndikim në rajonet e Gjirit Persik dhe të oqeanit Indian. Fuqia e tij influencuese në rajon arriti kulmin në shekullin e 19-të, pasi arriti të shtrihej përtej ngushticës së Bab Es-Selamit, deri në Emiratet e Bahkuara Arabe, Pakistan, Iran, e deri në Zanzibar, në jug (sot pjesë e Tanzanisë). Ndërsa në shekullin e 20-të, fuqia e tij filloi të binte, kohë kur Sultanati hyri nën ndikimin e Mbretërisë së Bashkuar.



SISTEMI I QEVERISJES NË OMAN

Sistemi i qeverisjes në Oman është “Sultanat i trashëguar”.

Sulltani aktual në Oman është Hejthem ibn Tarik Āl-Said, i cili e mori detyrën më 11 Janar të vitit 2020, pas vdekjes së Sulltanit Kabus ibn Said ibn Tejmur Āl-Said. Ky i fundit ka pasur sundimin më të gjatë në Lindjen e Mesme, deri në vdekjen e tij.

Kushtetuta e Omanit nuk lejon krijimin e partive politike, ndërsa çdo qytetar i vendit që ka arritur moshën njëzet e një vjeç, ka të drejtë të garantuar vote për të zgjedhur anëtarët e parlamentit^[3].

EKONOMIA

Ekonomia e Sultanatit të Omanit konsiderohet një ekonomi me të ardhura të mesme, dhe karakterizohet nga prania e burimeve të naftës dhe gazit. Nafta përbën 64% të fitimit të përgjithshëm nga eksporti, dhe 50% të prodhimit të brendshëm bruto. Sektori i produkteve të naftës konsiderohet një nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë së Omanit.

Sultanati i Omanit ka një sektor privat që karakterizohet nga fuqia dhe diversiteti, dhe që mbulon një numër aktivitetesh, përfshirë industrinë,

bujqësinë, tekstilet dhe turizmin. Industrinë kryesore në vend përfshijnë minierat dhe shkrirjen e bakrit, rafinimin e naftës dhe fabrikat e çimentos. Omani gjithashtu përpiqet të tërheqë investitorë të huaj në fushat e industrisë, teknologjisë së informacionit, turizmit, dhe në fushën e arsimit të lartë. Plani i zhvillimit industrial përqendrohet në burimet e gazit, prodhimin e hekurit, në petrokimikate dhe portet ndërkombëtare.

Monedha e Omanit është Rijali.

KLIMA

Klima e vendit është e nxehtë dhe e thatë në brendësi, ndërsa e nxehtë dhe e lagësht përgjatë bregdetit.

Temperaturat e verës në kryeqytetin Muskat dhe zonat e tjera bregdetare, shpesh ngjiten në 43 °C, me lagështi të lartë. Dimrat janë të butë, me zbritje mesatare të temperaturës deri në rreth 17 °C. Temperaturat në brendësi të territorit të vendit janë të ngjashme, megjithëse janë më të moderuara në zonat më të larta malore. Zona e Dhufarit është e dominuar nga monsunet verore, duke e bërë klimën e zonës së Salāles, më të butë se ajo e Omanit verior. Reshjet e shiut në të gjithë vendin janë minimale, me një mesatare prej vetëm 100 mm në vit, megjithëse reshjet në male janë më të shumta.

Për shkak të reshjeve të pakta, bimësia në vend është e rrallë, përveç ku ka ujë të organizuar, e cila sigurohet nga një sistem i lashtë i kanaleve ujore të njohura si “Eflāxh”. Këto kanale shpesh rrjedhin nën tokë, dhe burojnë nga puse që gjenden rrëzë maleve. Në vitin 2006, Eflāxhet e Omanit janë shpallur pjesë e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s.

POPULLSIA

Pjesa më e madhe e popullsisë së Omanit janë arabë, qofshin qytetarë autoktonë, ose arabë nga Jordania dhe Egjipti. Pjesa tjetër përbëhet nga pakica të emigrantëve nga Baloshistani, Afrika, India, dhe vendet e tjera.

GJUHA


Arabishtja është gjuha zyrtare, dhe në shkollë mësohet Arabishtja Moderne Standarte. Përveç kësaj, në Sultanatin e Omanit fliten një numër dialektesh të arabishtes, disa prej të cilave janë të ngjashme me ato që fliten në shtetet e tjera të Gjirit Arabik, por shumë prej të cilave nuk janë reciprokisht të kuptueshme me ato të rajoneve ngjitur.

Në vend flitet gjithashtu edhe anglisht, persisht dhe urdu, siç ka edhe një numër të popullsisë së Omanit që flasin suahili. Gjithashtu, aty fliten edhe gjuhë të ndryshme të Azisë Jugore.

FEJA

Shumica dërrmuese e popullsisë së Omanit janë muslimanë që ndjekin shkollën Ibādī, një degë e shkollës së Islamit Sunit. Pjesa tjetër e popullsisë që nuk ndjekin shkollën Ibādī, janë kryesisht Sunitë; ata të komuniteteve nga Azia Jugore janë kryesisht Shi'itë. Në Oman gjendet edhe një pakicë e besimit hindu.

Sultanati i Omanit është shembull i



tolerancës dhe i bashkëjetesës midis të gjitha sekteve fetare.

ISLAMI NE OMAN

Burime historike tregojnë se i Dërguari i Zotit, paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të, dërgoi një mesazh të shkruajtur në Oman, me anë të Ebu Zejd El-Ensari, drejtuar El-Xhelendit ose Xheferit, dy bijve të mbretit të Omanit asokohe, në vitin 6 të hixhretit. Pastaj, Profeti (a.s) u kishte dërguar atje edhe një mesazh tjetër, me anë të sahabiut Amru ibnul-As, në vitin 8 të hixhretit; pastaj edhe një mesazh të tretë, drejtuar popullit të Omanit. Transmetohet nga Ebu Shed'dad El-Demei, të ketë thënë: “Neve na erdhi mesazhi i Profetit, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, i cili ishte shkruar mbi një copë lëkure, ku thuhej: “Nga Muhamedi, i Dërguari i Zotit, për tek njerëzit e Omanit. Atëherë, pranojeni dhe deklarojeni dëshminë se “Nuk ka zot tjetër përveç All-llahut, dhe se unë jam i Dërguari i Zotit”! Jepeni Zekatin dhe ngrijini xhamitë,...!”

Si rezultat i këtyre mesazheve, dhe si rezultat i kontakteve të drejtpërdrejta të njerëzve të Omanit me të Dërguarin e Zotit, paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të, qoftë në mënyrë individuale ose në grupe, Islami u përhap gjerësisht në Oman. Këtë e ndihmoi edhe fakti se i Dërguari i Zotit e la qeverisjen e vendit në dorën e atyre që e kishin pasur edhe më parë atë, në dorën e bijve të El Xhelendiut, pasi ata e pranuan Islamin. Profeti (a.s) delegoi Amr ibnul-Asin në Oman, dhe e ngarkoi për mbledhjen e Zekatit nga të pasurit e vendit, dhe shpërndarjen e tij tek të varfrit dhe nevojtarët atje.

Shënimet historike tregojnë se populli i Omanit iu përgjigjën thirrjes së

të Dërguarit të Zotit, paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të, pa hezitim ose frikë.

Kur i Dërguari i Zotit, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, ndërroi jetë, Amr ibnul-As e la Omanin, duke u ndier i sigurt se ata e kishin pranuar fenë e Allahut me bindje dhe plot ndërgjegje. Ai u kthye në Medine, i shoqëruar nga një delegacion i Omanit të udhëhequr nga Abd ibn El-Xhelandi, një nga dy mbretërit e Omanit, edhe nga disa të tjerë. Kur ata erdhën tek Ebu Bekr Es-Sid'dik, njëri nga burrat e delegacionit u ngrit dhe tha: “O Kalifi i të Dërguarit të Zotit, o kurejshitë! Ja, ky ishte një amanet në duart tona e në besën tonë, një amanet i lënë tek ne nga i Dërguari i All-llahut, paqja dhe mëshira e All-llahut qofshin mbi të! Tani ne e dorëzuar atë tek ju”.

Ebu Bekri (r.a), iu drejtua atyre duke u thënë: “Njerëz të Omanit! Ju hytë në Islam me vullnetin tuaj!

I Dërguari i Zotit nuk e shkeli tokën tuaj, as me këpucë ushtari dhe as me patkonj kuajsh. Ju nuk e keni kundërshtuar atë si e kundërshtuan arabët e tjerë. Ju nuk shkakuat probleme duke u përçarë apo shpërndarë, prandaj All-llahu u mblodhi në mirësi, e pastaj dërgoi tek ju Amr bnul-Asin, pa ushtri dhe pa armë. Ju u përgjigjët pozitivisht kur ai ju thirri. Megjithëse vendbanimi juaj ishte larg nga këtu, ju iu bindët kur ju urdhëroi, pavarësisht numrit të madh tuajit dhe pajisjeve tua luftarake. A ka mirësi më të madhe sesa mirësia juaj, apo vepër më të nderuar se vepra juaj? Lavdërimi që ju ka bërë i Dërguari i All-llahut mjafton për ju, deri në Ditën e Ringjalljes. Pastaj i Dërguari i All-llahut dërgoi tek ju Amr ibnul-Asin, i cili sa qëndroi mes jush, qëndroi i nderuar, e kur u largua prej jush, u largua në paqe. Allahu ju favorizoi juve, kur bëri që Abdu dhe Xha'feri, dy bijtë e El Xhelendiut, u bënë muslimanë të parët. Allahu ju nderoi juve me Amr ibnul-Asin, por edhe këtë e nderoi me ju. Unë nuk kam frikë se do të shkaktoni trazira në vendin tuaj dhe as se do të ktheheni nga feja juaj. Allahu ju shpërbleftë me të mira!”^[4]

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe

- <https://www.worldometers.info/world-population/oman-population/>
- <https://www.britannica.com/place/Oman>
- <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/mu.html>
- <https://www.omvo.org/o/s.php?s=91>

NË RAHMET TË ALL-LLAHUT, I MIRI HAXHI HAFIZ MUSA HOXHA

Ditën e hënë, më 18 Ramazan 1441, që përkon më 11 maj 2020, u nda nga jeta kalimtare e kësaj bote të përkohshme, Haxhi Hafiz Musa Hoxha, imami dhe hoxha i dashur e sakrifkues i Anës së Malit.

Pas 94 vitesh plot sakrificë, mund e lodhje në kërkim të dijes para duarve të hoxhallarëve të Shkodrës; pas shërbimeve plot përkushtim në rrugë të All-llahut; pas vuajtjes dhe durimit në periudhën më të errët të historisë sonë kombëtare, atë të periudhës komuniste, si dhe pas gëzimit të madh të jetës, ditëve të para të nëntorit 1990, ku ishte në krye të besimtarëve në xhaminë e Plumbit, me këndimet e ëmbla të Kur'anit; pas një jete plot shërbime e përkushtim në rrugën e besimit dhe fesë, sot, në këtë ditë të bekuar të këtij muaji të begatë, ia dorëzoi shpirtin Krijuesit të tij.

Myftinia Shkodër, shpreh ngushëllim për besimtarët mbarë, për familjen Hoxha dhe për komunitetin e besimtarëve në Anën e Malit!

Rahmet i pastë shpirti!

Shkodër, më 11 maj 2020

✦ **“I privuar është ai, që është ndaluar nga begatia e njerëzve të kohës së tij!”...**

Para disa ditësh, një miku im postoi në një prej rrjeteve sociale të komunikimit një video të dijetarit të shquar sirian, Dr. Nurudin Itr. Në ligjëratën e tij, përballë një auditori të përzgjedhur, i dituri Shejh Itr, tregoi se kishte dëgjuar disa herë nga Hoxhë i tij, Shejh Abdulaziz Ujunusud, një urtësi, të cilën e kishte bërë objekt të ligjëratës në fjalë. Urtësia e Hoxhës së tij thoshte: “I privuar është ai, që është ndaluar nga begatia e njerëzve të kohës së tij!”.

Disa herë e dëgjova dhe e ridëgjova këtë pjesë, teksa një valë malli për hoxhallarët e mi, mësuesit dhe edukatorët, më përshkoi qenien time, duke më bërë të ndjehem i mangët pa prezencën e tyre të gjallë, pa fjalën e urtë, pa vështrimet e begata, pa praninë plot mirësi...

Atë natë, malli më shoqëroi në heshtje drejt dyerve të Zotërinjve të mi, të cilët i përshëndeta pa fjalë dhe më folën pa harfe... Atë natë, edhe në ëndërr, një njeri me mjekër të bardhë e fytyrë të dritshme, më bëri me shenjë të ngrihem për të falur sabahun... Si duket, takimet dhe prekjet begatuese të asaj nate,

deri në atë cak kishin mbërritur... Pas namazit të sabahut, u luta për Mësuesit dhe Hoxhallarët, për Edukatorët dhe Fjalëpakët, që me gjendjen e tyre, (para fjalëve), më edukuan dhe më frymëzuan me dritën e trashëgimisë së tyre shpirtërore...

Të nesërmen, isha i heshtur. Mendoja për natën që kaloi dhe urtësinë e Hoxhës



së shquar sirian, drejtuar nxënësit të tij (tashmë, dijetar dhe edukator i shquar botëror). Me mendjen time bëra një tavaf përreth Shkodrës, në kërkim të “njerëzve të kohës”, për të trokitur në dyert e tyre, në kërkim të begatisë...

I pari që më doli para syve, tamam si një shenjë e bukur Drite, ishte Hoxha ynë, trashëgimtari i derseve dhe mësimeve të hoxhallarëve të shkuar të Shkodrës... I vetmi i mbetur gjallë, Hafiz Musa Hoxha. (Shok dersi me hoxhallarët e shkuar, të nderuarit: H. Sabri Koçi, H. Sulejman Kraja, H. Selim Shabtafa, H. Qamil Tresi, H. Halit Mertoshi, H. Ali Hysi... etj, etj.)

Dhe me disa imamë të Shkodrës, (ndoshta me më pak, sesa realisht do të kishin dëshirë të ishin të pranishëm në këtë vizitë), e vizituam një pasdite, pasi kishim marrë leje më parë për këtë vizitë të shtrenjtë.

Dera e oborrit ishte hapur nga të dy anët e saj, ndërsa Hoxha me mjekrën e tij të bardhë dhe kokën e mbuluar, qëndronte në këmbë, lart te dera e shtëpisë... I mbështetur mbi bastunin e

tij, pak i kërrusur, aq sa për të mbajtur mbi supë 89 vitet e jetës së tij, na uronte mirëseardhjen, teksa na vështronte në hyrje të oborrit, drejt tij.

U përqaftua dhe dorë përdore hymë në dhomën e pritjes, që kishte marrë ngjyrë dielli, rrezet e të cilit depërtonin në heshtje nga një dritare e madhe përballë nesh.

U ulëm bri Hoxhës. Mjekra e tij e bardhë, fytyra e ndezur me dritë besimi, koka e mbuluar, pastërtia dhe parfumi i moshës së thyer, larë me ujë abdesi, sexhde nate e lexim Kur'ani, përkufizonin imazhin e tij, para syve të mi e zemrës, që në mall për Hoxhallarët e saj, mbështetej në krahët e pamjes së Hafizit të bardhë...

Dhe Hoxha nisi të fliste... Uronte e bekonte. Lutej për ne dhe sërish uronte e bekonte. Një këshillë e urtë, një fjalë e vjetër, një kujtim nga e shkuara e largët dhe një vështrim nga e nesërmja, mbështetur në të sotmen dhe prezenten, ishin cilësia e fjalëve të tij plot mall e gëzim, nga kjo vizitë e shumëpritur për moshën e tij të thyer.

Kisha dëshirë ta dëgjova, vetëm ta dëgjova e të vështroja në fytyrën e tij, teksa në orbitën e kësaj vizite më silleshin fjalët e Shejh Ujunusudit, në gojën e nxënësit të tij: “I privuar është ai, që është ndaluar nga begatia e njerëzve të kohës së tij!” dhe pohoja me zemër, duke konstatuar vërtetësinë e ndjerë të fjalës së tij të urtë.

Hafizi me fytyrë të ndritur, shpesh ndalonte së foluri, pastaj sërish e merrte fjalën, duke na marrë përdore drejt një kohe e një vendi, ndryshe nga koha jonë dhe vendi ynë... Ishin kohë me dijetarë dhe edukatorë, si mësuesit e tij të nderuar dhe hoxhallarët e kohës, që i përmendte me shumë krenari, seriozitet dhe përmallim...

“Hoxhallarët tanë H. Muhamed Bekteshi, Hafiz Sabri beg Bushati, Hafiz Esat Myftija, në xhaminë e të cilit bëja shpesh edhe mezinllëk, Sali ef. Myftija...”, e sa shumë hoxhallarë të nderuar e njerëz të mirë të kohëve të shkuara në Shkodrën time të shtrenjtë, përmendte Hafiz Musaja, në kujtimet dhe këshillat e tij, si mjekra e tij e bardhë...

Pastaj, për një moment, si për t'iu përgjigjur një pyetje-përgjigje që më sillej në mendje, teksa vështroja fytyrën e tij të bukur, Hoxha ynë i nderuar vazhdoi: “Kurrë nuk kam pi alkool, edhe pse na kanë sprovu shumë në periudhën e vështirë të ndalimit të fesë... Të gjitha xhenazet e Anës së Malit i kam vendur fshehtaz, në orë të vona të pasmesnatës, në borë e në shi, në dimër e në verë... Kisha frikë se dikush do na padiste, por na ka ruajtë i Madhi Zot... Durim të madh kemi ba... Sepse vetëm me durim kalohen sprovat e jetës, elhamdulillah!”, – tha ndër të tjera, si për të shënuar një testament besimi e një dëshmi kohësh të egra... Si për të thënë, se njeriu e ka në dorë, ta ruajë a jo veten e tij.

Na këshilloi e na uroi, u lut për ne e, sërish na kërkoi ta vizitonim e mos ta harronim.


Teksa ngriheshim, Hoxha insistonte të ulej deri poshtë për të na përcjellë, duke kaluar në dy palë shkallë të larta. Pasi u ulëm, dorë për dorë, mbështetur në bastunin e tij besnik, Hoxha u ndal për një moment, na vështroi dhe u lut me mirësinë e tij për ne, si një begati e bardhë, me të cilën na përcillte drejt derës së oborrit.

Teksa largoheshim, nga dritaret e mbyllura të makinës sonë vëreja se, Hoxha i mbështetur në bastunin e tij, diçka mërmëriste me vete, teksa vështronte nga ne... Unë, e ndiqja me nderim e respekt, teksa isha pushtuar nga urtësia e dijetarit të urtë damasken, që thoshte: “I privuar është ai, që është ndaluar nga begatia e njerëzve të kohës së tij!”

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

NDERIM PËR HAFIZ MUSA HOXHËN



Xhahid Bushati, shkrimtar

Gjithmonë kam menduar për ikjen e njerëzve nga kjo botë; veçanërisht nga mënyra se si ikin... p.sh.: për gjurmët që lënë, për mësimet dhe ëndrrat e vërteta që i falin kohës dhe brezave, për virtytet që mbjellin në zemrat e njerëzve... Pse kthehen në kujtesë? Pse i kërkojmë kujtimet e porsaikurit? Pse...?

Kështu mendova edhe për ty, Hafiz i dashur dhe i paharruar, që lajmi i ikjes tënde nga kjo botë, vërtet, më trishtoi. U pikëllova! Përmes lotëve të mi, thashë: “U largua një njeri i mirë, me një botë pastërtie hyjnore, për të cilin shoqëria jonë me realitetin plot kontraste e të dhimbshëm ka nevojë për të. Kështu që Hafiz i dashur duhej të qëndroje edhe ca... Por ishte kaderi i Zotit!

U largove në paqe dhe në heshtje, ndonëse rrezatoje në periferi, ndonëse metropolis të kishte zili. Vlerat më mirë se kushdo t'i njihnte Institucioni i Myftinisë së Qarkut – Shkodër.

U largove si një model, që jo shpesh përsëritet. Modele të tillë i kërkojmë, edhe atëherë kur mungesa është e dhimbshme, kur hapësira e ndarjes bëhet më e madhe. Modeli në këto çaste vjen e ridimensionohet dhe bëhet më aktual se kurrë.

Hafiz i dashur, ishe një model që nuk e lëvdove kurrë veten e as nuk doje të të lëvdonit të tjerët. Ishe një besimtar i devotshëm që zbatoje mësimet e Kuranit. Ishe një Mësues gojëmbël e gojëartë. Model i njerëzve të rrallë, të cilët duam t'i kemi pranë. Sepse duam të kemi buzëqeshjen e tyre pranë, duam të kemi mirësinë e tyre pranë, duam të kemi urtësinë dhe këshillën e tyre pranë. Ti ishte njëri prej tyre. U largove... kur

nuk duhej të largoheshe; por nuk je larguar. Urtësia jote dhe virtytet tuaja rrezatojnë e ndritin rrugën tonë të besimit mysliman me plot adhurime për Hazretin Muhamedin (a.s).

Hafiz i dashur, ti u largove pa shqetësuar askënd, pa gabimin më të vogël në jetë. Mund të na çudisë ky udhëtimi yt jetësor, por kjo është e vërtetë. Ndaj, je një libër jete që duhet shfletuar...

Qesh fatlum që të njoha në disa veprimtari të organizuara aq bukur nga Myftinija Shkodër.

Teksa sjell ndërmend portretin tënd, kuptoj se Ti ishe shkollë jete, për të cilën kemi nevojë.



ISHE NJË MËSUES GOJËMBËL E GOJËARTË. MODEL I NJERËZVE TË RRALLË, TË CILËT DUAM T'I KEMI PRANË. SEPSE DUAM TË KEMI BUZËQESHJEN E TYRE PRANË, DUAM TË KEMI MIRËSINË E TYRE PRANË, DUAM TË KEMI URTËSINË DHE KËSHILLËN E TYRE PRANË.

Hafiz i dashur, të kërkoj ndjesë, për fjalët e mia për Ty. Zemra më tha: “T'i thuash fjalë falënderimi, atij që mbeti i nderuar në jetë dhe e nderoi jetën!” Unë zbatova një porosi të saj.

Shkoder, 12.05.2020.

NDËRROI JETË HOXHA I URTË, HAXHI HAFIZ MUSA HOXHA (1926-2020)

Në moshën 94 vjeçare, ndërroi jetë në Shkodër, Hoxha i urtë anamalas, Haxhi Hafiz Musa Hoxha, i fundit i nxënësve të përkushtuar të hoxhallarëve të vjetër të Shkodrës.

Hafiz Musa Isuf Hysejn Nuro Hoxha, ka lindur në fshatin Babot të Anës së Malit-Shkodër, në vitin 1926.

Në autobiografinë e tij, ai tregon për: “16 vitet e rinisë së tij dhe ditët e saj të mbushura me ecejake dyerve të hoxhallarëve të njohur të Shkodrës si: H. Muhamed Bekteshi, H. Esat Myftija, H. Ibrahim Kaduku, H. Smajl Abdia i Tepes, etj., te të cilët kishte kënduar ders dhe kishte filluar hatmen e Kur’anit Kerim, vasin, gramatikën arabe, etj. “Në vitin 1944 jam prezantuar për të parën herë me Hafiz Esat Myftinë. Me të kam ba ders dy orë në ditë, me abdest”, dëshmon për mësuesit e tij.

“Te Haxhi Muhamed Bekteshi ishim 30 vetë. Na thoshte se deri më sot kishte nxjerrë tri palë talebe... Me kulturën që na ka dhanë ai, nuk mund t’i dalim kurrë hakut, kaq Hoxhë i naltë ka kenë. Na ka mësuar pasë frikë Zotin, me pasë karakter feje, jo m’u mburrë me diploma e ixhazet!”.

“Në moshën 14 vjeçare kam shkuar imam për të parën herë në jetë. Ndonëse i padekretuar, kam shërbyer 30 netë teravi, në fshatin Milan. Pastaj, në vitin 1945 e 1946 kam shku Imam në Reç dhe për dy vjet i kam mësuar edhe fëmijët. Më 13 janar 1947 na morën ushtarë. Aty kam qëndruar 3 vjet e gjysmë. Në mars të vitit 1950 erdha Imam këtu në fshatin Vejuka, ku qëndrova rreth 9 vjet. Prej aty kam shkuar Imam në fshatin Vallas, ku kam qëndruar edhe aty rreth 9 vjet.

Edhe gjatë kësaj kohe kam vazhdu me marrë derse në Shkodër. Në orën 4 të mesnatës nisesha prej këtu në Babot, me biçikletë dhe në orën 7 isha të Çinari i Hoxhë Dheut, për të filluar dersin. Aty ishim me krejt shokët: Hafiz Sabriu, Hafiz Qamili, Haki Halili, Hafiz Haliti, Hafiz Yzejri...”.



Duke treguar për kujtimet e periudhës komuniste dhe ndalimin e fesë, thotë: “Katër kintal qitabe m’i kanë marrë, megjithëse jam mundu me i fshehtë disa, por pjesa më e madhe është zhdukur. Hoxhallarët e Shkodrës më kanë dashur fort dhe më kanë dhuruar libra.

Për shembull, kam marrë qitabe prej Haxhi Muhamed Kastratit, prej Hafiz Ibrahim Kadukut. Kur vdiq Hafiz Jusuf Këlmendi (1876-1943), të cilin s’e kam njohur, qitabet e tij më erdhën dhuratë nga ca të njohur që më donin si talebe dhe kërkues i dijes islame...”.

Kur m’i dogjën librat e bibliotekës, njiu para fshatit, arrita të shpëtoj këto copa... (Merr frymë thellë, fshin sytë dhe vazhdon rrëfimin tij) U thoja njerëzve: M’i merrni pjesët e librave... Më ndihmoni t’i shpëtoj librat e mi...! Kështu i kam ruajtur copa-copa qitabet, për mos me i harru...!”.

“Kurrë nuk kam pi alkool, edhe pse na kanë sprovu shumë në periudhën e vështirë të ndalimit të fesë... Të gjitha xhenazet e Anës së Malit i kam vendú fshehtaz, në orë të vona të pasmesnatës, në borë e në shi, në dimër e në verë... Kisha frikë se dikush do na padiste, por na ka rujtë i Madhi Zot... Durim të madh kemi ba... Sepse vetëm me durim kalohen sprovat e jetës, elhamdulillah!”.

Ai kujton me shumë emocion procesin e hapjes së xhamisë së parë, në nëntor të vitit 1990: “Kur u hap feja, Hafiz Sabri Koçi më çoi haber me ardhë në xhaminë e Plumbit dhe më tha: “Ti ke hivzin e Kur’anit, prandaj duhet me fillu mukabelet”. Për tri javë rresht kam këndu Kur’an në xhami të Plumbit, ashtu si dikur”.

Në botimin me titull: “Hafiz Musa Hoxha – vaizi besnik i qitabeve të vjetra”, Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed Sytari tregon edhe për një pyetje që i kishte drejtuar Hafizit të moshuar: “Hafiz, çfarë mungon sot, në krahasim me kohën tuaj? Ai, buzëqesh rregullon çallmën e tij dhe merr të flasë: “Tash ka ma shumë libra se at’herë. Edhe miradif ka ma shumë se at’herë. Por, sot mungon... A e di se çfarë mungon? E kam shumë kasavet, po jua tham: Kam lexu para shumë kohësh një rivajet, ku Resulull-llahi, duke përmendur shenjat e kiametit, ka thanë: “Ngrihet dituria, shtohet injoranca, shtohet imoraliteti dhe ndërtohen xhamitë duke qenë harab përbrenda”... Kjo mungon sot, frika e Zotit dhe forca e besimit!” dhe Hafizi merr pamje mëshiruese dhe lutëse teksa flet me shumë zemër për kasavetin tij...”.

All-llahu e mëshiroftë dhe e shpërbleftë për shërbimet dhe përkushtimin e tij ndaj njerëzve!

NJOFTIM PËR FALJEN E XHUMASË DHE FITËR BAJRAMIT

Sipas udhëzimit zyrtar të Komunitetit Mysliman i Shqipërisë, nr. 240 Prot., datë: 18.5.2020, për rifillimin e aktivitetit fetar në xhami, ju bëjmë me dije se:

– Duke nisur nga dita e nesërme, datë 22.5.2020 dhe në vazhdim do të fillojë falja e namazit të xhumasë në të gjitha xhamitë e vendit.

– Dita e diel, më 24.5.2020, është dita e parë e Fitër Bajramit. Ceremonia e Fitër Bajramit do të zhvillohet nëpër xhamia, nga ora: 5.30, ndërsa Falja e namazit të Fitër Bajramit bëhet në orën: 6.00.

NJOFTIM PËR FITËR BAJRAMIN 1441/2020

- Dita e diel, më 24.5.2020, është dita e parë e Fitër Bajramit.
- Ceremonia e Fitër Bajramit do të zhvillohet nëpër xhamia, duke filluar nga ora: 5.30, ndërsa falja e namazit të Fitër Bajramit bëhet në orën: 6.00.
- Ceremonia e pritjes tradicionale të vizitorëve zhvillohet në xhaminë e Parrucës, nga ora: 9-10.30.
- Sadekatul-Fitri dhe fidja për këtë vit janë 300 lekë të reja për person.

– Ceremonia e pritjes tradicionale të vizitorëve zhvillohet në xhaminë e Parrucës, nga ora: 9-10.30.

– Sadekatul-Fitri dhe fidja për këtë

vit janë 300 lekë të reja.

Myftinia Shkodër ju uron: Agjërim të pranuar dhe me zemër të mirë Fitër Bajramin!



Ditën e diel, më 3 maj 2020, përfaqësuesi i Myftinisë Shkodër, teologu Lavdrim Hamja me disa të rinj nga fshati Drisht vizituan familjen e z. Bashkim Radaj dhe panë nga afër gjendjen e vështirë dhe kushtet e mjerueshme, në të cilat banonte.

Në prononcim për mediat, teologu Hamja falënderoi rininë e fshatit Drisht, emigrantët e zonës së Postribës dhe të gjithë ata, të cilët u treguan të gatshëm të ndihmojnë këtë familje.

Teologu Hamja, ndër të tjera tha: “Fillimisht është detyrë e institucioneve përkatëse, që qytetarëve të vendit t’u sigurojnë kushtet minimale të jetës dhe të banesës. Nuk është e drejtë, që



dikund të derdhen miliona lekë pa asnjë mbikëqyrje, ndërkohë që ka familje, të cilat nuk kanë as kushtet minimale të jetës dhe as të banimit. Në këtë familje,

TË NDIHMOJMË FAMILJEN RADAJ

varfëria jo vetëm është ulur këmbëkryq, por ka zënë vendin e njerëzve dhe nuk i lë të jetojnë!”.

Me këtë rast, Myftinia Shkodër dhuroi disa pako ushqimore, pasi kjo familje nuk zotëronte as me çfarë të ushqehet.

Rinia e fshatit morën angazhim që të kontribuojnë me fuqi punëtore për rregullimin e kësaj banesë.

Myftinia Shkodër bën thirrje, që çdokush që ka mundësi të kontribuojë, që kjo familje të jetojë në mënyrë dinjitoze si gjithë qytetarët e tjerë të këtij vendi.

SHPËRNDAHEN 70 PAKO USHQIMORE PËR LAGJEN ZOGAJ

Ditën e xhuma, më 8 maj 2020, Myftinia Shkodër me mbështetjen e Qendrës Islame Shqiptare në Sindej të Australisë, me rastin e muajit të begatë të Ramazanit, bënë shpërndarjen e 70 pakove ushqimore për banorët e lagjes Zogaj.

Myftinia Shkodër falënderon Qendrën Islame Shqiptare në Sidnej për këtë



kontribut të vyer, veçanërisht në këtë situatë të vështirë që po kalon vendi ynë dhe imamin e xhamisë Zogaj, z. Ylber Rupa për realizimin e këtij projekti.

Myftinia Shkodër i bën thirrje të gjithë atyre që kanë mundësi ta mbështesin projektet e ndryshme bamirëse që Myftinia Shkodër realizon në shërbim të komunitetit dhe njerëzve në nevojë.

U ZHVILLUA CEREMONIA E HATMES SHERIFE TË RAMAZANIT 1441

Ndonëse në një gjendje akoma të kufizuar për shkak të masave të marra pas pandemisë Covid 19, Myftinia Shkodër organizoi ditën e martë, më 19 maj 2020, në xhaminë e Parrucës, ceremoninë tradicionale të përfundimit të Hatmes Sherife (leximit të plotë të Kur’anit Famëlartë).



MYFTINIA SHKODËR NË MBËSHTETJE TË PARA-TETRAPLEGJIKËVE

Paraditen e mërkurë, më 20 maj 2020, Myftinia Shkodër, me rastin e muajit të begatë të Ramazanit, shpërndau 50 pako ushqimore për personat para-tetraplegjikë.

Në fjalën e tij, kryetari i Shoqatës së Para-Tetraplegjikëve, z. Saimir Beqiri tha: “Ky aktivitet u realizua falë mbështetjes së vazhdueshme që na jep Myftinia Shkodër me drejtues Imam Muhamed B. Sytari. Shprehim mirënjohje dhe falënderime të përzemërta për këtë kontribut të dhënë në ndihmë direkte



për këto familje. Urojmë në këtë muaj të shenjtë sa më shumë mirësi, tolerancë dhe solidaritet mes njëri-tjetrit”.

Ky projekt u arrit falë bashkëpunimit me xhaminë Wil, të Zvicrës.

SHPËRNDAHEN 200 PAKO USHQIMORE PËR FAMILJET NË NEVOJË

Paraditen e mërkurë, më 20 maj 2020, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me fondacionin “Mirënjohja” realizuan shpërndarjen e 200 pakove ushqimore për familjet në nevojë, nga projekti “Zekatul-Fitri” në kuadër të fushatës “Sibakul-Hajr” (Gara e mirësisë) të shtetit të Kuvajtit.



Myftinia Shkodër falënderon fondacionin “Mirënjohja” për këtë kontribut me vlerë të madhe, veçanërisht në këtë kohë krize të pandemisë që ka përfshirë vendin.

FAMILJA CURRI ME SHTËPI TË RE PËR FITËR BAJRAM

Ditën e shtunë, më 23 maj 2020, në prag të festës së Fitër Bajramit, familja Curri në fshatin Drisht të Postribës u gëzua me inaugurimin e shtëpisë së re.

Me këtë rast, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një vizitë në shtëpinë e tyre, ku i uroi për banesën e re.



Myftiu falënderoi të gjithë vëllezërit e nderuar të zonës së Postribës, që megjithëse larg vendlindjes në emigracion, kanë kontribuar nga hallalli i tyre për të ndihmuar këtë familje në nevojë.

Myftiu tha se shembulli i vëllezërve të Postribës është modeli i të rinjve që i duhen vendit, që punojnë, sakrifkojnë dhe ndihmojnë ata që kanë nevojë.

Myftiu falënderoi edhe angazhimin e koordinitorit të këtij projekti bamirës, z. Zamir Milani, sikurse tha se Myftinia Shkodër do ta përkrahë në vazhdimësi këtë familje dhe fëmijët e saj.

FITËR BAJRAMI, DITË GËZIMI, MOMENT REFLEKTIMI!



Ditën e diel, më 24 maj 2020, që në orët e para të mëngjesit, muslimanët e Shkodrës tejmbushën xhamitë e qytetit dhe të fshatit, për faljen e namazit të sabahut dhe vazhdimin me ritualet e Fitër Bajramit të këtij viti.

Kjo pamje ngazëlluese, ishte pamja më e bukur e tij viti, sidomos pas një periudhe të mbushur me propagandë frike e paniku, për shkak të realitetit global, me të cilin po përballet bota.

Kjo ishte dëshmia më e bukur se Islami në këtë qytet e në këtë vend po lulëzon e po rimëkëmbet, si asnjëherë tjetër në historinë e tij shumëshekullore, si një bekim për këtë popull e këtë tokë.

Ceremonia kryesore e Fitër Bajramit të sivjetshëm u zhvillua në xhaminë e Parrucës, ku dy imamët e saj, H. Naim Drijaj dhe H. Durim Kasemi, ligjruan para besimtarëve, duke hedhur dritë mbi detyrat e muslimanit pas

Muajit Ramazan dhe shembullin e të devotshmëve, që All-llahu i Madhëruar i quan në Kur'anin Famëlartë, si: "robët e të Gjithëmëshirshmit".

Imamët e nderuar thanë se përkushtimi i Muajit Ramazan duhet dëshmuar që nga dita e sotme e në vijim, për të dëshmuar secili mirësinë dhe bekimet e fituara në Muajin e Begatë.

Ligjëratat kryesore e kësaj dite ishte ajo e Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, nëpërmjet të cilës ai drejtoi disa mesazhe për të pranishmit, për politikën, për shoqërinë shqiptare dhe mbi të gjitha ftoi besimtarët për t'u zgjuar nga rutina dhe për t'u përgatitur për përgjegjësitë e mëdha që ka muslimani i këtij shekulli.

Nën drejtimin e Myftiut u bë edhe falja e namazit të Fitër Bajramit, ndërsa hytbeja e kësaj feste u mbajt nga imami i xhamisë, H. Naim Drijaj.



Ai falënderoi në mënyrë të veçantë imamin e kësaj xhamie, H. Ilir Dizdari, i cili ka shërbyer me përkushtim të madh, duke e gjallëruar këtë xhami, duke afruar rininë, duke përhapur mirësi e paqe,

harmoni e besim në komunitet.

Me këtë rast, i dorëzoi atij një "Certifikatë Mirënjohjeje", për kontributin e vyer në përhapjen e mësimave islame, për afrimin e rinisë, ruajtjen e frymës së harmonisë ndërfaqetare dhe edukimin e brezit të ri me frymën e udhëzimit islam, në detyrën e tij si imam i xhamisë së fshatit Bardhaj.

Nga ana e tij, imami i nderuar shprehu falënderimet e tij për Myftiun dhe Myftininë Shkodër, sikurse falënderoi këshillin e xhamisë, besimtarët dhe nxënësit e shumtë për frymën e bashkëpunimit dhe dashamirësisë, me të cilën është ndërtuar kjo xhami dhe aktiviteti i saj.

FALËNDERIM DHE MIRËNJOHJE PËR IMAMËT TANË

PROGRAMI I RAMAZANIT 1441/2020
"RRUGËS SË PËRKUSHTIMIT" (1)
(Çdo ditë, ora: 11.00 - E xhuma, ora 13.00)

Nr.	Data	Tema	Ligjërsuesi
1	E Enjte 23.4.2020	MESAZHI I RAMAZANIT 1441	Imam Muhamed Sytari Myfti i Zonës Shkodër
2	E Xhuma 24.4.2020	MESAZHI I XIUMASË	Imam Muhamed Sytari Myfti i Zonës Shkodër
3	E Shkurt 25.4.2020	ÇFARË ESHTË RAMAZANI?	H. Gilman Kasari Imam - xhamia "Ebu Bekri"
4	E Diel 26.4.2020	ADHURIMI NË RAMAZAN	H. Lavdrin Hamja Imam - xhamia e "Dy Vajzave"
5	E Hënë 27.4.2020	RANDERSIA ESHTË DITË	H. Naim Drijaj Imam - xhamia Parrucë
6	E Martë 28.4.2020	AGJIRIMI DHE SHËNDËTI	H. Aden Plaga Imam - xhamia Parrucë
7	E Mërkurë 29.4.2020	FALJA E MIRËSITË JETË	H. Durim Kasemi Imam - xhamia Parrucë
8	E Enjte 30.4.2020	MËSHIRA E ALL-LLAHUT (NUSË)	H. Idmir Plaka Imam - xhamia "Ebu Bekri"
9	E Xhuma 1.5.2020	MESAZHI I XIUMASË	Imam Muhamed Sytari Myfti i Zonës Shkodër
10	E Shkurt 2.5.2020	RIFITIMI E KUR'ANIT	H. Gilman Kasari Imam - xhamia "Ebu Bekri"
11	E Diel 3.5.2020	AGJIRIMI DHE VLERË E PËRKUSHTIMIT NGA KUR'ANI	H. Adil Cukali Imam - xhamia e Medresës
12	E Hënë 4.5.2020	FALJA E ALL-LLAHUT (NUSË)	H. Lavdrin Hamja Imam - xhamia Parrucë
13	E Martë 5.5.2020	AGJIRIMI DHE BUKURI	H. Naim Drijaj Imam - xhamia "Dy Vajzave"
14	E Mërkurë 6.5.2020	AGJIRIMI DHE PËRSOSIA E ADHURIMEVE	H. Ruzhdi Plangaj Imam - xhamia Kuris
15	E Enjte 7.5.2020	RAMAZANI NË FAMILJE	H. Arben Hallani

Myftinia Shkodër shpreh falënderimet dhe mirënjohjen e saj të thellë për kontributin e madh dhe të çmuar për imamët e saj të përkushtuar, të cilët përgjatë gjithë periudhës së gjendjes së jashtëzakonshme të krijuar për shkak të pandemisë globale, ishin të pranishëm me ligjëratat e tyre të përditshme, pranë besimtarëve dhe qytetarëve shkodranë dhe përtej tyre, duke dhënë mesazhe të urta, plot shpresë, besim dhe optimizëm, duke përcjellur fjalën e Zotit, Traditat e Pejgamberit (a.s.), fjalët e urta të brezave të shkuar, plot largpamësi dhe në koherencë me periudhën e begatë të Tre Muajve të Mirë.

All-llahu (xh.sh) ia shpërbleftë me mirësitë e Tij në këtë botë dhe në jetën e përtejme.

PROGRAMI I RAMAZANIT 1441/2020
"RRUGËS SË PËRKUSHTIMIT" (2)
(Çdo ditë, ora: 11.00 - E xhuma, ora 13.00)

Nr.	Data	Tema	Ligjërsuesi
1	E Hënë 11.5.2020	"PEJGAMBERI (A.S.) MËSHIRË PËR MBARË BOTËN"	H. Lavdrin Hamja Imam - xhamia e "Dy Vajzave"
2	E Martë 12.5.2020	VLERË E SADAKËS NË RAMAZAN	H. Ervil Kuçi Imam - xhamia Dërgut
3	E Mërkurë 13.5.2020	DHJETË DITËSHI I FUNDIT I RAMAZANIT	H. Altin Nikshiqi Imam - xhamia Dërgut
4	E Enjte 14.5.2020	RENDERSIA E PIRËS SË TRITË DHE E FUNDIT NË RAMAZAN	H. Idmir Plaka Imam - xhamia "Ebu Bekri"
5	E Xhuma 15.5.2020	MESAZHI I XIUMASË	Imam Muhamed Sytari Myfti i Zonës Shkodër
6	E Shkurt 16.5.2020	KËSHILLA PROFETIKE	H. Durim Kasemi Imam - xhamia Parrucë
7	E Diel 17.5.2020	VLERË E NATËS SË KABRIT	H. Arben Hallani
8	E Hënë 18.5.2020	RENDERSIA E SINDORITETIT NË ISLAM	H. Adil Cukali Imam - xhamia e Medresës
9	E Martë 19.5.2020	KËSHILLA KUR'ANORE	H. Altin Nikshiqi Imam - xhamia Dërgut
10	E Mërkurë 20.5.2020	PËRKUSHTIMI NGA KUR'ANI FAMILIARË	H. Gilman Kasari Imam - xhamia "Ebu Bekri"
11	E Enjte 21.5.2020	SI TA MËVILLIM MUJIN E BEGATË NË RAMAZAN?	H. Idmir Plaka Imam - xhamia "Ebu Bekri"
12	E Xhuma 22.5.2020	MESAZHI I XIUMASË	Imam Muhamed Sytari Myfti i Zonës Shkodër

MYFTIU: "RINIA E JONË TË ZGJOHET DHE TË LARTËSOHET ME BESIM E DIJE!"

Ditën e xhuma, më 29 maj 2020, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mbajti hytben e xhumasë në xhaminë e fshatit Bardhaj, ku iu drejtua të rinjve muslimanë me një mesazh që lidhet me frymën e rizgjimit dhe rimëkëmbjes islame.

Myftiu lexoi disa nga ajetet e sures "Jusuf", ku theksoi se rinia e jonë ka nevojë të lexojë në thelbin e ajeteve të kësaj sureje, shembullin e besimtarit të suksesshëm, që mbështetur mbi prapen e besimit, nuk e humb shpresën, por përherë triumfon, përtej sprovave dhe pusive të jetës.

Ai tha se shembulli i Hz. Jusufit (a.s.),

është modeli i besimtarit me peshë dhe influencë në shoqëri, model i dijes dhe aftësive, si dhe nxitje për të rrezatuar besnikëri, dije, guxim dhe vetëbesim në forcat dhe dhuntitë e fituara në jetë.

Myftiu iu drejtua të pranishëmve: "Ju të dashur të rinj jeni të ftuar të ndiqni shembullin e Hz. Jusufit (a.s.) për t'u bërë nesër njerëz me pozitë më shoqërore tuaj, nëpërmjet rrugëve të dijes! Nëse doni që nesër të jeni dikush dhe të keni një pozitë, këtë mund ta arrini nëpërmjet sineritetit tuaj me Zotin dhe besimin në All-llahun e Madhëruar, por nëpërmjet rrugëve të dijes! ...

Nëpërmjet shembullit të Hz. Jusufit (a.s.), All-llahu i Madhëruar na fton të

besojmë dhe të shpresojmë për një të ardhme, ku muslimanët të kenë fjalën e tyre, vendimin e tyre, pozitën e tyre, fjalën e tyre, ndryshe nga realitetet e këtyre dekadave, ku të gjithë jeni dëshmitarë të dyfytirësisë, investimeve selektive, përpjekjes për të dëmtuar tabanin kombëtar, e ngjashëm me këtë, vetëm e vetëm për lënien pas dore të muslimanëve dhe zonave të tyre!

Koha është për t'u zgjuar, për një rimëkëmbje të dëshmuar, për gjallërimin e jetës tonë fetare dhe ndryshimin e gjuhës së komunikimit, për t'u ndarë nga folklorizmat dhe fryma e tyre mpirëse e mbytëse!"



JEHONË RAMAZANI NË MEDIET AUDIO-VIZIVE TË SHKODRËS

Myftinia Shkodër si çdo vit gjatë muajit të bekuar të Ramazanit, përveç aktiviteteve dhe veprimtarive të ndryshme kulturore dhe fetare, organizon edhe emisione dhe programe televizive dhe radiofonike.

Në **Tv1 Channel**, tashmë është bërë traditë që emisioni "Ramazani midis nesh" të jetë pjesë e vazhdueshme e programacionit të kësaj media si dhe transmetimi i dy ezaneve në kohët e sabahut (syfyrin) dhe akshamit (iftarit), pikërisht për të lajmëruar besimtarët për mbarimin e syfyrin dhe fillimin e iftarit. Gjatë këtij emisioni të përditshëm janë



dhënë ligjërata dhe këshilla nga imamë dhe teologë, si dhe mesazhe e pasqyrime të hytbes së ditës së xhuma.

Ndërsa **Tv Rozafa**, çdo natë, rreth orës: 19⁰⁰ ka transmetuar live ligjëratat me shumë vlerë për besimtarët, nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i cili gjatë derseve të tij ka dhënë mesazhe dhe këshilla të dobishme për audiencën në lidhje mirësjelljen islame, rregullat dhe dobitë e agjërimit, pozitën e lartë të familjes në Islam, etj.

Një rol të rëndësishëm për pasqyrimin e programeve të Ramazanit ka pasur edhe **Star Plus Tv**, ku çdo pasdite rreth 30 minuta ka transmetuar intervista dhe bashkëbisedime me personalitete të ndryshme fetare të sferave të ndryshme nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, diaspora etj., të realizuar nag gazetari i mirënjohur, z. Ferdinand Samarkhi.

Një tjetër media që ka kontribuar për të pasqyruar jetën shpirtërore gjatë gjithë ditëve të bekuara të Ramazanit



është edhe Radio Jehona, e cila çdo ditë rreth dy orë para dhe pas iftarit si dhe pas syfyrin ka transmetuar programe dhe rubrika të larmishme si: "Ramazani dhe Besimtarët", "Me fjalët e Allahut", "Pejgamberi (a.s) ka thënë", "Islamijetë", "Dua-lutje", ezanët në kohë reale, ilahi, etj.

Me këtë rast Myftinia Shkodër, falënderon të gjitha mediet audio-vizive, që kanë bashkëpunuar për të pasqyruar të gjitha aktivitetet, mesazhet dhe prononcimet mediatike të saja gjatë muajit të madhëruar të Ramazanit si dhe për transmetimin live të ceremonisë së Fitër Bajramit.



HUMANISTJA E SHPËTUAR ITALIANE: E PRANOVA ISLAMIN ME VULLNETIN TIM

Punonjësja e shpëtuar humanitare italiane, Silvia Constanza Romano, e cila ka pranuar Islamin thotë se është konvertuar me vullnetin e saj dhe jo me forcë, transmeton Anadolu Agency (AA).

Romano, 25 vjeçare, ishte rrëmbyer në qytetin juglindor bregdetar të Kenias, Chakama në nëntor të vitit 2018.

Ajo u shpëtua të dielën përmes përpjekjeve të përbashkëta nga shërbimet e inteligjencës turke, somaleze dhe italiane.

"Ata më siguruan se nuk do të vritesha dhe ashtu ndodhi", i tha Romano agjencisë italiane të lajmeve ANSA.

Në konvertimin e saj në Islam, Silvia tha se kjo ndodhi derisa ishte peng.

"Ishte spontane dhe jo e detyruar. Në ato muaj më dhanë një Kuran dhe falë rrëmbyesve të mi mësova edhe pak arabisht", tha ajo.



"Ata më shpjeguan arsyet dhe kulturën e tyre. Procesi im i konvertimit ka qenë i ngadaltë në muajt e fundit. Nuk ka pasur martesë apo lidhje, vetëm respekt".

Zëvendësministria e Jashtme e Italisë pranoi bashkëpunimin turk gjatë

operacionit të shpëtimit.

"Ka pasur bashkëpunim me shërbimin e inteligjencës turke për ta lokalizuar dhe ndërmarrë veprime në kohën e duhur", tha për kanalin televiziv LA7, Marina Sereni.

(www.shenja.tv)

Gruaja myslimane bëhet gjyqtarja e parë në botë që mban hixhab

Një grua në Britani e cila është bërë gjyqtarja e parë në botën perëndimore që mban një hixhab, shpreson të jetë një frymëzim për gratë muslimane.

Raffia Arshad, 40 vjeç, e cila u rrit në Yorkshire, në veri të Anglisë, ka dashur të punojë si juriste që kur ishte 11 vjeç. Arshad, u emërua javën e kaluar një gjykatëse në qarkun Midlands.

Ajo tha se promovimi i saj ishte një lajm i shkëlqyeshëm për diversitetin në sistemin juridik më të respektuar në botë. Arshad tha që zyra gjyqësore po kërkonte

MYSLIMANIA BËHET GJYQTARJA E PARË NË BRITANI QË MBAN HIXHAB



të nxiste diversitetin, por kur e emëruan atë nuk e dinin që ajo mbante hixhab. "Është e rëndësishme për të gjitha

gratë, jo vetëm për gratë myslimane, por është veçanërisht e rëndësishme për gratë myslimane".


Arshad, një nënë e tre fëmijëve, ka praktikuar të drejtën private që merret me fëmijë, martesë të detyruar, gjymtim gjenital të grave dhe raste të tjera që përfshijnë ligjin islam për 17 vitet e fundit. Ajo ishte e para në familjen e saj që shkoi në universitet dhe gjithashtu ka shkruar një tekst drejtues për ligjin islamik të familjes.

(www.infoshqip.com)

Omer Ishrak, një mysliman i devotshëm me origjinë Bangladesho-Amerikane, drejtori ekzekutiv i kompanisë "Medtronic", që zotëron pajisjen më të fuqishme në botë për t'u përballur me virusin Covid-19 (coronavirusin), pajisje për frymëmarrje artificiale (respirator), nga profili i tij në twitter, më 30 mars 2020 deklaroi botërisht, se kompania që drejton do të dhurojë falas të drejtën e autorësisë së prodhimit për çdokënd, i cili dëshiron të prodhojë një pajisje të tillë (respirator), me qëllim që të shpëtojë sa më shumë jetë njerëzish.

Gjithashtu, z. Ishrak ka dhuruar edhe projektin, planin, dizajnimin dhe mënyrën e prodhimit, duke përfshirë të

OMER ISHRAK DHURON PROJEKTIN PËR PRODHIMIN E RESPIRATORËVE



gjitha çështjet e nevojshme teknike falas, për gjithë botën.

Ai hoqi dorë nga e drejta e pronësisë së prodhimit dhe monopolit duke i vënë ato në shërbim të njerëzimit.

Me këtë gjest, ai ka hequr dorë nga miliona dollarë, apo më mirë të themi, nga miliarda e miliarda parë, nëpërmjet këtij akti sublim - duke dëshmuar krejtësisht të kundërtën atyre që mendojnë se "myslimanët nuk dinë asgjë tjetër përveç lutjes (duasë) dhe se dijen e progresin e presin prej të tjerëve."

Falënderim dhe mirënjohje!

Myftinia Shkodër shpreh falënderimet e saj më të përzemërta për kontribuuesit e devotshëm, që iu gjenden pranë, në periudhën e vështirë të pandemisë globale, si dhe me rastin e muajit të madhërishëm të Ramazanit, duke bërë që projektet bamirëse të Myftinisë Shkodër të përfshinin një numër të madh dhe të konsiderueshëm familjesh në nevojë.

ALL-LLAHU I SHPËRBLEFTË ME MIRËSITË E TIJ TË PAKUFISHME.

NË VEÇANTI:

- Ambasada e Shtetit të Kuvajtit, Tiranë
- Bashkësia Islame Shqiptare Wil, Zvicër
- Bashkësia Islame Shqiptare ALKIG, Austri
- Bashkësia Islame Shqiptare Sidnej, Australi
- Fondacioni "Mirësia", Tiranë
- Fondacioni "Mirënjohja", Tiranë
- Fondacioni "Fundjavë Ndryshe", Tiranë
- Shoqata "Istanbul", Shkodër
- Biznesmenë dhe bamirës të ndryshëm në SHBA, Kanada, Gjermani, Itali, Zvicër, Austri, Maqedoni etj, si dhe në Shkodër, të cilët preferuan të ngelen anonimë.

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org